



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:007761

Datë: 05.07.2023

Numri i dokumentit: 04453878

PS.nr.31/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI SPECIAL, në përbërje të trupit gjykues, gjyqtarëve Arben Hoti - kryetar, Mentor Bajraktari dhe Lutfi Shala - anëtar të trupit gjykues me zyrtaren ligjore Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurve Dh.H për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së, F.M për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së, D.SH për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së, K.C për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së dhe N.O për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.04/2021 të dt.07.07.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit të fundit gjyqësor publik të datës 24.04.2023 në të cilën ish-in të pranishëm prokurori i shtetit Dren Paca, e pandehura Dh.H me mbrojtësin av.Florent Latifaj sipas autorizimit, F.M me mbrojtësin Av.Mehdi Geci sipas autorizimit, D.SH me mbrojtësit av.Tahir Rrecaj dhe av.Agon Rrecaj sipas autorizimit, K.C me mbrojtësen av.Albana Kelmendi sipas autorizimit dhe N.O me mbrojtësin av.Hajzer Salihu sipas autorizimit, pas seancës për këshillim dhe votim me datë 28.04.2023, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurve:

1. Dh.H, e bija ... dhe ... e gjinisë ..., e lindur me dt.... në M..., me numër personal të letërnjoftimit ..., me vendbanim në ..., Komuna Prishtinë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, ka të kryer studimet master, e punësuar, profesoreshë në Kolegjin "...", e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.
2. F.M, i biri i ... dhe ....., e gjinisë ....i, i lindur me dt.... në fshatin ..., Komuna Skenderaj, me numër personal ....., me vendbanim në ....., Komuna Fushë Kosovë, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. D.SH, i biri i ... dhe nëna ....., e gjinisë ....., i lindur me dt..... në .... – Republika e Serbisë, me vendbanim .... në Fushë Kosovë, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer fakultetin ekonomik, me profesion ekonomist, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
4. K.C, i biri i ... dhe ..., e gjinisë ..., i lindur me dt... në .., me numër personal ..., me vendbanim në ....., Komuna Prishtinë, i martuar, baba i fëmijëve, me profesion Inxhinier, i punësuar profesor në Universitetin ....., i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
5. N.O, i biri i ... dhe ..., e gjinisë ....., i lindur me dt..... në .., me numër personal ....., me vendbanim në .... – Komuna Prishtinë, i martuar, baba i tre fëmijëve, doktor i shkencave filozofike, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, të pandehurit:

#### LIROHEN NGA AKTAKUZA

#### SEPSE

I. Me dt.11.05.2018, në Prishtinë, e pandehura Dh.H, në cilësi të ... - MIE, kishte tejkaluar kompetencat e saj, me qëllim të mundësimit të përfitimit të dobisë pasurore personit tjetër respektivisht Operatorit Ekonomik - OE "Majorelle PR & Events", në atë mënyrë që përmes "Kërkesës", me nr.prot.01/873-1-2018, dt.11.05.2018, kishte kërkuar nga ..., i pandehuri D.SH nisjen e procedurave të prokurimit për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të konsulencës për nevojat e MIE-së", duke e përcaktuar procedurën e prokurimit që duhej aplikuar (procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë një burimore) dhe emrin e OE "Majorelle PR & Events", me të cilin duhej lidhur kontrata nga MIE edhe pse e kishte ditur se në bazë të ligjit të Prokurimit Publik, neni 16 të Rregullores numër 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 6/121 të datës 22.04.2010 nuk ishte në kompetencën e ... që (1) të inicioje procedurën e prokurimit, (2) të përcaktonte se cila procedurë e prokurimit duhej aplikuar dhe (3) të përcaktoj emrin e OE me të cilin duhej lidhur kontrata, në këtë mënyrë ia mundësoj OE "Majorelle PR & Events", që me dt. 17.08.2018 të lidhë kontratë me MIE, në vlerë prej 180,000.00 Euro dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore po në këtë vlerë.

Me dt.21.02.2019 Prishtinë, e pandehura Dh.H, në ... së ... - MIE, kishte tejkaluar kompetencat e saj, me qëllim të mundësimit të përfitimit të dobisë pasurore personit tjetër respektivisht OE të njëjtë "Majorelle PR & Events", në atë mënyrë që përmes "Kërkesës" dt.21.02.2019, nr. 01/257-1-2019, kishte kërkuar nga U.D Sekretari i Përgjithshëm i MIE-së i pandehuri K.C, vazhdimin e kontratës në bazë të procedurës të njëjtë edhe pse e kishte ditur se në bazë të ligjeve në fuqi nuk kishte kompetencë e Ministrit që të paraqesë kërkesë për vazhdimin e kontratës, në këtë mënyrë ia mundësoj OE "Majorelle PR & Events", që me dt.28.03.2019 të vazhdoj kontratën me Autoritetin Kontraktues MIE në vlerë prej 168,000.00 Euro dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore në këtë vlerë.

Po ashtu me dt.24.04.2019, e pandehura Dh.H, në ... së Integritimeve Evropiane - MIE, kishte tejkaluar kompetencat e saj, me qëllim të mundësimit të përfitimit të dobisë pasurore personit tjetër respektivisht OE "Madison Global Strategies LLC", në atë mënyrë që përmes "Kërkesës" me nr.prot.667-1-2019, dt.24.04.2019, kishte kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MIE-së i pandehuri K.C, nisjen e procedurave të prokurimit për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të konsulencës për nevojat e MIE-së", duke e përcaktuar procedurën e prokurimit që duhej aplikuar (procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë një burimore) dhe emrin e OE "Madison Global Strategies LLC", me të cilin duhej lidhur kontrata nga MIE edhe pse e kishte ditur se në bazë të ligjeve në fuqi nuk kishte kompetencë e ... që (1) të inicioje procedurën e prokurimit, (2) të përcaktonte cila procedurë e prokurimit duhej aplikuar dhe (3) të përcaktoj emrin e OE me të cilin duhej lidhur kontrata, në këtë mënyrë ia mundësoj OE "Madison Global Strategies LLC", që me dt.17.06.2019 të lidh kontratë me Autoritetin Kontraktues MIE në vlerë prej 152,232.00 Euro dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore në këtë vlerë.

- Me këtë në vazhdimësi kishte për kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së.

II. Me dt.11.05.2018, i pandehuri F M, në cilësi të ..., të MIE-së, duke e shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përftimin e dobisë pasurore personit tjetër OE "Majorelle PR & Events", në atë mënyrë që me anë të kërkesës me nr.prot 874-1-2018, dt.11.05.2018, drejtuar ..- së - te pandehurit D.SH si dhe kërkesës nr.prot.268-1-2019, dt.22.02.2019, po ashtu drejtuar .. — të pandehurit U.D -K.C, me anë të cilave kishte kërkuar që kërkesat parashtruara nga e pandehura Dh H, për lidhjen dhe vazhdimin e kontratës me OE "Majorelle PR & Events" të pranoheshin, edhe pse ishte në dijeni se kërkesat e lartcekura ishin parashtruar në kundërshtim me ligjin të Prokurimit Publik, neni 16 të Rregullores numër 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 6/121 të datës 22.04.2010 pasi që Ministria nuk ishte personi kompetent për të (1) iniciuar procedurën e prokurimit, (2) përcaktimin e procedurës së prokurimit që duhet aplikuar si dhe (3) caktimin e emrit e OE me të cilin duhet lidhur kontratën, ia mundësoj OE "Majorelle PR & Events", që me dt.17.08.2018 të lidh kontratë me MIE dhe me dt.28.03.2019 ta vazhdoj atë dhe si rrjedhojë edhe përftimin e dobisë pasurore në vlerë të përgjithshme prej 348,000.00 Euro.

Po ashtu me dt.07.05.2019, i pandehuri F M, në ..., të MIE-së, duke e shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përftimin e dobisë pasurore personit tjetër OE "Madison Global Strategies LLC", në atë mënyrë që me anë të kërkesës, me nr.prot 765-1-2019, dt.07.05.2019, drejtuar ..- së - të pandehurit K.C, me anë të cilës kishte kërkuar që kërkesa e parashtruara nga e pandehura Dh H, për lidhjen kontratës me OE "Madison Global Strategies LLC" të pranoheshin, edhe pse ishte në dijeni se kërkesa e lartcekur ishte parashtruar në kundërshtim me ligjin, pasi që .. nuk ishte personi kompetent për të (1) iniciuar procedurën e prokurimit, (2) përcaktimin e procedurës së prokurimit që duhet aplikuar si dhe (3) caktimin e emrit të OE me të cilin duhet lidhur kontratën, ia mundësoj OE "Madison Global Strategies LLC", që me dt.17.06.2019 të lidh kontratë me MIE dhe si rrjedhojë edhe përftimin e dobisë pasurore në vlerë prej 152,232.00 Euro.

- Me këtë në vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së.

III. Me datë 11 Maj 2018, i pandehuri D.SH, në cilësinë e ..-së, duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përfitim të dobisë pasurore personit tjetër OE "Majorelle PR & Events", në atë mënyrë me dt.11.05.2018, aprovoi kërkesën e parashtruar nga .. - i pandehuri F.M dhe lejoi zbatimin e Procedurës së Prokurimit të inicuar nga e pandehura Dh H, edhe pse ishte në dijeni se kërkesa e lartcekur ishte parashtruar në kundërshtim me ligjin të Prokurimit Publik, neni 16 të Rregullores numër 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 6/121 të datës 22.04.2010 dhe se Ministria (1) nuk ishte personi kompetent për të iniciuar procedurën e prokurimit, (2) nuk ka kompetencë për përcaktimin e procedurës së prokurimit që duhet aplikuar si dhe (3) nuk ka në kompetencë për caktimin e emrit të OE me të cilin duhej lidhur kontrata, të cilin aktivitetit të prokurimit me datë 23.06.2018 e kishte pezulluar ndërsa po të njëjtin aktivitet të prokurimit e kishte lejuar të vazhdonte me datë 29.05.2018 dhe në këtë mënyrë ia kishte mundësuar OE "Majorelle PR & Events", që me dt.17.08.2018 të shpërblehej me kontratë dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore në vlerë prej 180,000.00 Euro.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së.

IV. Me dt.22.02.2019, i pandehuri K.C, në cilësi të ...së, duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përfitim të dobisë pasurore personit tjetër OE "Majorelle PR & Events", në atë mënyrë që me anë të kërkesës "Kërkesës, Autorizimi dhe Deklarata për ZKA", në përgjigje të Kërkesës së .. të MIE - të pandehurit F M, aprovoi kërkesën e të njëjtit dhe lejoi zbatimin e Procedurës së Prokurimit të inicuar nga e pandehura Dh H, edhe pse ishte në dijeni se kërkesa e lartcekur ishte parashtruar në kundërshtim me ligjin të Prokurimit Publik, neni 16 të Rregullores numër 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 6/121 të datës 22.04.2010 dhe se Ministria (1) nuk ishte personi kompetent për të iniciuar procedurën e prokurimit, (2) nuk ka në kompetencë përcaktimin e procedurës së prokurimit që duhet aplikuar si dhe (3) nuk ka në kompetencë për caktimin e emrit të OE me të cilin duhej vazhduar kontrata, në këtë mënyrë ia kishte mundësuar OE "Majorelle PR & Events", me dt.28.03.2019 vazhdimin kontratës me MIE dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore në vlerë prej 168,000.00 Euro.

Po ashtu me dt.06.05.2019, i pandehuri K.C, në cilësi të ...-së, duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përfitim të dobisë pasurore personit tjetër - OE "Madison Global Strategies LLC", në atë mënyrë që me anë të kërkesës "Kërkesës, Autorizimi dhe Deklarata për ZKA", në përgjigje të Kërkesës së .. të MIE - të pandehurit F M, aprovoi kërkesën e të njëjtit dhe lejoi zbatimin e Procedurës së Prokurimit të inicuar nga e pandehura Dh H, edhe pse ishte në dijeni se kërkesa e lartcekur ishte parashtruar në kundërshtim me ligjin dhe se Ministria (1) nuk ishte personi kompetent për të iniciuar procedurën e prokurimit, (2) nuk ka në kompetencë përcaktimin e procedurës së prokurimit që duhet aplikuar si dhe (3) nuk ka në kompetencë për caktimin e emrit të OE me të cilin duhej lidhur kontrata, në këtë mënyrë ia kishte mundësuar OE "Madison Global Strategies LLC", me dt.17.06.2019 lidhjen e kontratës me MIE dhe si rrjedhojë edhe përfitimin e dobisë pasurore në vlerë prej 152,232.00 Euro.

- Me këtë në vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së.

V. Me dt.17.08.2018, i pandehuri N O, në cilësi të U.D ...-së, duke e shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përfitimin e dobisë pasurore personit tjetër - OE "Majorelle PR & Events", në atë mënyrë që edhe pse ishte në dijeni se sipas ligjit të Prokurimit Publik, neni 16 të Rregullores numër 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 6/121 të datës 22.04.2010 Ministrja (1) nuk ishte personi kompetent për të iniciuar procedurën e prokurimit, (2) nuk ka në kompetencë përcaktimin e procedurës së prokurimit që duhet aplikuar si dhe (3) nuk ka në kompetencë për caktimin e emrit të OE me të cilin lidhur kontrata, i njëjti me dt.17.08.2018, nënshkroi kontratën me OE "Majorelle PR & Events" në vlerë prej 180,000.00 euro dhe në këtë mënyrë ia mundësoi përfitimin e dobisë pasurore po në këtë vlerë.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së.

E dëmtuara Qeveria e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

Shpenzimet e procedurës bien ne barre te mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m i

### 1. Historiku i procedurës

1.1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë me numër PPS.nr.04/2021 të dt.07.07.2021, kundër të pandehurve Dh.H për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414/2 lidhur me nenin 77/1 të KPRK-së, F.M për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414/2 lidhur me nenin 77/1 të KPRK-së, D.SH për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414/2 të KPRK-së, K.C për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414/2 lidhur me nenin 77/1 të KPRK-së dhe N.O për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414/2 të KPRK-së.

### 2. Shqyrtimi fillestar

2.1. Kryetari i trupit gjykues pas pranimit të lëndës, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 01.09.2021 të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Iliriana Qollaku - Tafa, të pandehurit; Dh.H me mbrojtësin me Av.Florent Latifaj sipas autorizimit, F.M me mbrojtësin Av.Mehdi Geci sipas autorizimit, D.SH me mbrojtësit av.Tahir Rrecaj dhe Av.Agon Rrecaj sipas autorizimit, K.C me mbrojtësen av.Albana Kelmendi sipas autorizimit dhe N.O me mbrojtësin av.Hajzer Salihu sipas autorizimit.

2.2. Të pandehurve i është lexuar aktakuza, ndërsa kryetari i trupit gjykues pasi u bind se të pandehurit e kanë kuptuar përmbajtjen e akuzës, të njëjtëve i dha mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarojnë të pafajshëm.

Të gjithë të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm lidhur me veprat penale me të cilat i ngarkon aktakuza.

2.3. Pasi që të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë gjykata ka marr aktvendim PS 31/21 me datë 12.10.2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuara kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimit të provave të ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve. Gjykata e Apelit e Kosovës me datë 02.12.2021 pas shqyrtimit të ankesave të mbrojtëse kundër aktvendimit të cituar më lart ka marr aktvendim me të cilin ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve duke vërtetuar aktvendimin PS 31/21 të datës 12.10.2021.

### 3. Shqyrtimi gjyqësor dhe deklarimi i dëshmitarëve.

3.1. Pasi që të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve ku prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin rastin dhe kërkesat e tyre, ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi ka vazhduar me dëshminë e dëshmitarëve.

3.2. Dëshmitarja V H gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: se punon në Ministrinë e Integritetit Evropian (në tekstin e mëposhtëm MIE), në 2013 ka qenë këshilltare politike e ministres V C pastaj ka vazhduar këshilltare tek ministri B Q, pasi ka mbaruar mandatin ky i fundit, ka bërë pauzë për një vit dhe pasi ishte hapur një konkurs në ministri, për barazi gjinore, që ishte në kuadër të MIE kishte aplikuar dhe ishte pranuar dhe pas një deri në dy vite ishte zgjedhur udhëheqëse e IT dhe logjistikes në MIE.

Dëshmitarja ka shtuar se lidhur me kontratën lobuese që është lidhur nga MIE ka njohuri pak a shumë sepse tani ka kaluar një kohë dhe nuk i kujtohen ato kontrata, kjo edhe për faktin sepse është shkëputur gati dy vite nga puna për shkak të lindjes, por dhe para lindjes ishte liruar nga Qeveria dhe se ka mundur me i harruar disa gjëra. Lidhur me kontratën e operatori ekonomik (në tekstin e më poshtëm OE) Majorelle PR & Events dhe Madison Global me të cilën MIE ka lidhur kontratë, ka shtuar se ka qenë në komision, ka pranuar faturën e shërbimeve tek kontrata me kompaninë amerikane është shprehur dëshmitarja pra te Majorelle PR & Events e kam fjalën ka deklaruar kjo dëshmitare dhe puna e saj ishte për negociim për me diskutuar për uljen e çmimeve dhe me ulë çmimin e kontratës. *Roli im tek OE Majorelle PR & Events si anëtare e komisionit ka qenë për të pranuar faturën dhe për të bërë pagesa për ato shërbime. Anëtarë të tjerë të këtij komisioni kanë qenë si kryetar N N dhe T mbiemri i të cilit nuk po me kujtohet, më duket ka qenë A, ka deklaruar dëshmitarja.*

Dëshmitarja gjatë dëshmisë së saj ka theksuar shtuar se si komision kishin qenë te emëruar nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë përmes e-mailit për me negociuar me kompaninë në fjalë për ulje të çmimit. Tutje ka dëshmuar citat; *në email ka qenë në kontratë edhe shërbimet por tani nuk po më kujtohet, se te Majorelle ka qenë kontrata e nënshkruar ka pas me ardhur fatura me shërbime që i kanë kryer, kur kam qenë në atë cilësi nuk e kam nënshkruar faturën për pagesë. Ndërsa te rasti tjetër kemi negociuar për uljen e çmimit me kompaninë Amerikane se emri nuk po më kujtohet. Ka theksuar se raporti i Operatorit Ekonomik Majorelle PR & Events ka pas të bëjë me shërbimet që i kanë kryer të cilat kanë qenë të listuara dhe unë e kam pasur edhe në gjuhën shqipe, ka qenë edhe në gjuhën angleze në email.*

3.3. Dëshmitarja B.C gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: se nga marsi i viti 2011 ka qenë në zyrën e prokurimit si zyrtare e lartë deri në shuarjen e ministrisë, ku ka punuar për çështje të prokurimit. Kërkesa për inicim të procedurës që ceket dhe lidhjen e kontratës me OE Majorelle PR & Events është iniciuar nga ministrja Dh H, lidhur me kërkesë janë cekur rrethanat precize, urgjencë ekstreme me këtë operatorë, d.m.th. me një operatorë OE Majorelle PR & Events. Ka shtuar se si anëtare e komisionit për negociim të kontratës, negociatat për kontratën e parë janë zhvilluar përmes e-mailit të OE Majorelle PR & Events ndërsa për vazhdimin e kontratës negociatat janë zhvilluar në Paris në zyrat e OE. Ka theksuar se negociatat ishte deshtë me u ftua prej autoritetit kontraktues (në tekstin e mëposhtëm AK), por pasi që operatori nuk ka mujtë me ardhur atëherë jemi detyrua me marrë vendim ashtu që negociatat kanë filluar përmes e-mailave ndërsa radhën e dytë është negociua në Paris. Më tej ka theksuar se përgjegjës për të iniciuar një procedurë të prokurimit në ministri është njësia e kërkesës sipas ligjit, ku në rastin konkret është ministrja. Ka shtuar se meqenëse ka qenë procedurë e jashtëzakonshme ndoshta ka pas të drejtë për inicim të procedurës së prokurimit por nuk jam kompetente për këtë gjë. Lidhur me çështjen e negociimit kur kanë shkuar në Paris ka shtuar se ishim tre anëtarë që kemi qenë të caktuar për negociata N N në cilësinë e kryetarit të komisionit, B V d.m.th. unë dhe V N. Po ashtu, në negociata kanë qenë edhe udhëheqësi i divizionit të prokurimit F.M dhe sekretari i përgjithshëm i ministrisë K Z dhe menaxheri i kontratës G D, si dhe shpenzimet kanë qenë nga MIE dhe mëditje kemi marrë. Drejtori i prokurimit, sekretari i përgjithshëm dhe menaxheri i kontratës nuk kanë qenë pjesë e komisionit negociues, mirëpo kanë ardhur sepse kanë pas me nënshkruar kontratën, ndërsa menaxheri i kontratës ka ardhur për të biseduar lidhur me raportet që do ti sjellin lidhur me mënyrën e raportimit me OE. Ka shtuar se në Paris kanë shkuar për të negociuar kontratën dhe këto persona kanë dashtë të jenë pjesë e negociatave dhe kontrata nuk është nënshkruar gjatë kësaj vizite vetëm se janë bërë negociatat. Më tej ka theksuar se OE Majorelle PR & Events për nevojat e MIE ka kryer shërbime për konsulencë, monitorimin e mediave, caktimin e agjendave. Ka shtuar se gjatë vlerësimit të procesin me OE Majorelle PR & Events nuk kemi pas ndonjë presion nga udhëheqësi i prokurimit F.M e as nga dikush tjetër. Më tej ka shtuar se procedurat e prokurimit në MIE i inicon zakonisht zyrtarët, pastaj i aprovon sekretari, udhëheqësi, si dhe kërkesat mund t'i bëj çdo zyrtarë, i aprovon udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë apo sekretari. Ka cekur se pasi nuk ka njësi të veçantë për të kërkuar inicimin e procedurës .. Dh.H ka pas të drejtë për inicimin e procedurës së negociuar të prokurimit, pasi që është procedurë e jashtëzakonshme. Tutje ka cekur se para fillimit të negociatave me OE Majorelle PR & Events ka qenë i ndarë buxheti për një kontratë të tillë. Meqenëse kanë qenë dy kontrata me OE ndarja e buxhetit për kontratën e dt.10.07.2018 që është objekt i akuzës duhet para procedurës me u nda dhe vlera e buxhetit e ndarë lidhur me këtë kontratë ka qenë 180.000 euro, pastaj në bazë të vlerës është caktu për sa muaj me u vazhduar kontrata, nuk kemi pas ndërhyrje nga askush lidhur me këto kontrata, e as nga D.SH nuk ke pas ndërhyrje ka deklaruar dëshmitarja. Ka theksuar se si anëtare e komisionit dhe zyrtare e lartë e prokurimit në rastin e kontratës me Majorelle PR & Events janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore dhe të gjitha kanë qenë në rregull. Ka shtuar se në Paris kanë qenë për vazhdim të kontratës, si dhe këto kontrata i nënshkruar udhëheqësi i prokurimit dhe OE, ndërsa në rastet kur janë me vlerë më të madhe i nënshkruan edhe sekretari dhe ministri. Tutje ka cekur se dallimi mes kërkesës për inicim të procedurës dhe kërkesë për paraqitje të nevojës është se kërkesa për inicim të procedurës është kërkesa e cila aprovohet nga sekretari dhe vije për procedura të më tutjeshme në zyre të prokurimit, këtë kërkesë e paraqet njësia e kërkesës. Si dhe ka shtuar se nuk ka ndonjë dispozitë që e ndalon që inicimi i kontratës të bëhet në objektet e MIE apo jashtë objektit.

3.4. Dëshmitari V H gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në MIE kam filluar punën me 17.06.2019 në pozitën zyrtar i lartë ligjor për legjislacion të BE-së në Departamentin e të Drejtës së BE-së, që do të thotë Departamenti i të Drejtës së BE-së është autoritet kyç që e mbikëqyr përafrimin e legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së. Ka theksuar se gjatë implementimit të kontratës me këta OE ka qenë anëtarë i komisionit për pranimin e faturës të muajit tetor 2019, për Majorelle PR & Events, në cilësi të anëtarit të komisionit, ku ka qenë i ftuar nga kolegë të mi që janë emërua të cilët janë V J dhe B X jemi takuar për të diskutuar edhe d.m.th. kemi shqyrtuar shërbimet që i ka krye OE. Pastaj, njëri prej anëtarëve të komisionit V J me sa e mbaj unë nga departamenti tjetër i MIE, ka kërkuar që na si komision me kërkuar informacione shtesë të aktiviteteve që janë kryer nga OE për muajin tetor dhe pikërisht përmes menaxherit të kontratës ka kërkuar me ju drejtuar OE për informata shtesë për aktivitetin që e kanë krye. Ka shtuar se si anëtarë të komisionit për vlerësimin e faturës së muajit tetor 2019 për OE Majorelle PR & Events, të gjithë kanë qenë unik për refuzimin e kësaj fature për mos pagesë. Më tej ka theksuar se objekt i kësaj kontrate ka qenë promovimi i integritit evropian të Kosovës dhe lobimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare veçmas në Francë përmes aktiviteteve integruese, krijimi i rrethimit, takimet me institucionet e BE dhe lobimi i Kosovës për shkak se në atë kohë ka qenë edhe një fushatë kundër njohjes në arenën ndërkombëtare.

3.5. Dëshmitari N N gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në kompaninë M G ka qenë më shumë i angazhuar ka theksuar se do të sqarojë rutinën ditore në pika të përgjithshme duke shtuar se është negociua duke u bazuar në praktiken e mëhershme të Majorelle PR & Events, negociimi me përfaqësues të organizatës është bërë nga distanca përmes mjeteve elektronike, nuk ka pas kontakt fizik me ta dhe kjo ka qenë krejt kjo d.m.th. cilësia, karakteristikat e kontratës, sasinë e çmimit etj. Pastaj te çmimi dhe gjërat tjera kemi pas një pyetje që mundemi me u ndërlidh p.sh. një pyetje pasuese ka qenë: “si ka ardhë deri tek çmimi”, më kujtohet shumë mirë, unë jam përgjigj “komplet planifikimi buxhetor është i qasshëm për çdo kënd, për subjekte fizike dhe juridike, për njerëz në atë kohë”. Sa i përket mjeteve të zotuar për këtë aktivitet prokurimi ka shtuar se nuk ka qenë i përfshirë në pjesën e aktivitetit të prokurimit, ndërsa nga propozimi i parë që ka ardhë nga OE kanë arrit që ta ulin çmimin. Më tej ka theksuar kanë qenë pesë shtylla kryesore që kanë pas të bëjnë me rritjen e subjektivitetit të Kosovës në arena ndërkombëtare, në organizatat e përbashkëta ku merr pjesë BE dhe SHBA, në planifikimin e dokumenteve strategjike, në koordinimin e fondeve të huaja dhe natyrisht njohjen e Kosovës në aktivitet ndërkombëtar, e kam fjalën për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shteti i Izraelit dhe kur po e përmendi Izraelin jam i sigurtë që e keni në procesverbalin e deklaratës sime në prokurori dhe kjo njohje ka ardhur në vitin 2021, ka shtuar dëshmitari. Më tej ka theksuar se në vitin 2010 kur është miratuar vendimi i kryeministrit Th, janë afërsisht 25 plus minus (+/-) më tepër të cilat tregojnë për fushë veprimtarinë në BE. Këtu hyn një kategori ku nuk mund ti përcaktoj për shkak se nuk mund ti mbaj në mend ku shihet qartë bashkëpunimi ndërkombëtar, marrëdhëniet mes BE dhe Kosovës, bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, përafrimi i legjislacionit të Kosovës me BE e cila më pas, pas një pune shumë dinamike në kryesimin e ish-sekretarit Sh e cila është pasur nga ministra H është mbajtur një trend-dinamikë e fushë veprimtarisë së IE. Ka shtuar se fushë veprimtarisë e MIE është shtruar edhe jashtë Bashkimit Evropian, pasi që fushëveprimi i MIE dhe MPJ janë fushëveprime komplementare që e plotësojnë njëra tjetrën, bashkërendojnë aktivitete të përbashkëta. Momentin kur flitet për BE duhet të kemi parasysh se është organizatë dhe jam shumë i sigurtë që ndoshta edhe ish sekretari Sh ka diskutuar më herët, vetë marrëveshje MSA ka komponentë ndërkombëtare që lidhet me OBT dhe shumë protokolle tjera shtesë që tejkalojnë ose që e komplentojnë dimensionin e përbashkët me ministri tjera. Lidhur me marrëveshjen që ka lidhë MIE me OE Madison Global ka shtuar se e di që është kërkuar suspendimi i aktiviteteve nga ana e OE me arsyetimin sepse kemi një situatë të re politike dhe mundësinë që këto



aktivitete të rifillojnë më pëlqimin e qeverisë së re. Më tej ka theksuar se objekti i kontratës me Madison Global, pesë aktivitete, nuk mund ti përmendi një pas një ka theksuar dëshmitari. Ka shtuar se si pjesë e OE Madison Global, ka qenë periudha kur është realizu negociimi i kontratës, ka qenë komunikim elektronik përmes email-it ashtu siç e lejon fusha e kontratës një burimore.

3.6. Dëshmitari D A gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se sa i përket biografisë profesionale puna që ndërlidhet me dëshminë të cilën edhe sot jam i ftuar me ardhë para kësaj gjykate ndërlidhet me disa pozicione që i kam mbajtur në MIE fillimisht si zyrtar i lartë ligjor, udhëheqës i divizionit për çështje të BE si dhe për tre vite kam ushtruar pozitën e Drejtorit të Departamentit të së Drejtës së BE apo shkurtimisht Departamenti Ligjor në MIE. Përveç kësaj jam inkuadruar edhe si ligjërues në Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë dhe aktualisht nga viti 2019 prej 1 shkurt punoj në Gjykatën Kushtetuese si Këshilltar i Lartë Kushtetues Juridik, pak a shumë kjo është përmbledhja. Në bazë të kërkesës që iu është drejtuar Departamentit të BE-së këtë analizë dhe këtë opinion e kam përpiluar në bazë të njohurive që e kam pas dhe normalisht që qëndroj pranë kësaj edhe sot. Lidhur me kërkesën formale, ka shtuar se fillimi i kërkesës për përpilim të opinionit ka qenë ftesa nga tashmë ish-ministrja në kabinetin e saj e cila ka kërkuar që në kuadër të fushë-veprimit të kompetencave të Departamentit Ligjor të MIE-së të bëjë analizimin e kërkesës që kabineti i ministres kishte kërkuar për shërbime ndërkombëtare të konsulencës përkatësisht për angazhimin e kompanisë Majorelle PR & Events. Ftesën e kam marrë në telefon të zyrës, besoj se dikush prej asistenteve të ish-ministres në atë kohë dhe më ka thënë se ju fton ministrja në takim. Në takim ministrja e ka sqaruar në pika të përgjithshme nevojën për nënshkrimin e kësaj marrëveshje të konsulencës ndërkombëtare, e ka shpreh hezitimin e saj në kontest të asaj që sekretari i atëhershëm i ministrisë kishte rezerva për procedurën e propozuar të prokurimit publik dhe e njëjta kërkoi që nga Departamenti Ligjor të përpilohet një opinion në periudhë rekord për një orë ose diçka të tillë. Normalisht, që përgjigja ime ishte e tillë që konstatonte që kjo fillimisht ishte e pamundur, e dyta nuk hyn në fushëveprim të Departamentit Ligjor apo Departamentit të drejtës së BE-së, e drejta që secili institucion e ka njësinë përkatëse të prokurimit publik dhe e katërta Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (në tekstin e mëposhtëm KRPP) në bazë të ligjit për prokurim publik është i mandatuar për interpretimin e ligjit. Kërkesa e saj ishte e drejtpërdrejtë dhe aty përfundoj faktikisht takimi, takimi ishte i shkurtë. Më pas, kam pranuar kërkesën formale e cila është edhe e reflektuar në këtë opinion nga ana e sekretarit me dy pyetje konkrete, pyetjet janë” “analizimi i ekzistimit të kushteve faktike lidhur me përmbushjen e kërkesave ligjore që burojnë nga neni 35.2.1., paragrafi 1 i LPP-së dhe pika e dytë “analizimin e ekzistimit të kushteve faktike për marrjen e vendimit për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë”, rrjedhimisht ky ka qenë objekti i kërkesës formale nëse mundem me qajtë. Më tej ka theksuar se pozita e ministres në kuadër të MIE-së, ka shtuar se kjo çështje është e rregulluar edhe me legjislacion në fuqi, ndarja e nivelit politik dhe nivelit civil normalisht që posti i ministrit nënkupton titullarin e institucionit dhe nuk hyn në fushëveprimin e stafit civil, për më tepër Qeveria si bartës i funksionit ekzekutiv bën mbikëqyrjen e shërbimit civil dhe përcakton orientimet politike të ministrisë në fjalë. Ka shtuar se personat kompetent në kuadër të MIE-së për të inicuar një procedurë të prokurimit e kanë mundësinë ta bëjnë njësitë brenda ministrisë për nevojat e tyre përkatëse. Po e zëmë ka kërkesa të caktuara për mallra ose shërbime të caktuara dhe çdo herë në fund vit përpilohet një lloj kushtimisht me quajt listë të kërkesave për mallra dhe shërbime që i kanë njësitë e caktuara brenda institucionit. Në parim kjo është kush ka të drejtë se sa e kuptoj këtë fushë të bëj kërkesë për mallra, shërbime të cilat i nënshtron procedura e prokurimit. Gjithashtu ka theksuar se në opinionin që e kam ofruar në ministri të cilën e kam theksu që është i karakterit ndihmues për lehtësimin e marrjes së vendimit nga vendimmarrësit

të institucionit dhe në bazë të analizës që e kam bërë për një periudhë të shkurtër kohore pasi që edhe natyra ka qenë urgjente unë e kam pa që legjislacioni e përcakton që përmes aktit nënligjor rrjedhimisht nenit 3 të UA 02-2012 të KRPP-së e cila thotë: “marrja e vendimit për përdorim të procedurave sipas nenit 32, 35 dhe 61 të këtij ligji është përgjegjësi e plotë e zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe zyrtarit kryesor administrativ të autoritetit kontraktues”. Rrjedhimisht ky ka qenë ajo në bazë të hulumtimit që e kam zhvillu. Ka shtuar se sa i përket OE ajo veçse dihet d.m.th. procedura është e tillë, e dizajnuar, në negociata direkt me një OE e cila derivon kërkesën që e kishte përpiluar ish-ministrja. Majorelle PR & Events ka qenë e theksuar në kërkesën e datës 10.05.2018 në të cilën ishte bërë edhe elaborimi i shkaqeve pse kjo OE duhej të angazhohej për shërbimet e konsulencës ndërkombëtare. Më tej ka shtuar se këtë e sheh si proces të ndarë, inicimi edhe vendimmarrja për inicim të procedurës, d.m.th. inicimi si kërkesë që derivon nga një njësi e institucionit dhe duhet bërë një kërkesë dhe më pas është faza e vendimmarrjes për inicimin formal të saj në bazë të procedurave të prokurimit. Analizimi i paraqitur në opinion e merr të mirëqenë kërkesën fillestare dhe si e tillë ishte zyrtare (protokoluar) për më tepër ministria në atë kohë kishte zhvilluar edhe një komunikim me disa institucione në kontest të qartësimit se a është e lejuar procedura e përcaktuar me nenin 35.2.1. paragrafi 1 i LPP-së ku spikasim kërkesat drejtuar KRPP-së. KRPP deri në momentin kur ky opinion është përgatitur dhe kishte dhënë përgjigje sa i përket aspektit procedural të inicimit të kësaj kërkesë nëse duhet për saktësi është shkresa me nr.prot.48/2018 e dt.22.05.2018 ku theksohet: “se a janë plotësuar kërkesat ligjore sa i përket aspektit procedural deri më tani është konform kërkesave të nenit 35, rrjedhimisht sa i përket kësaj çështje KRPP veç e ka dhënë një përgjigje për inicim të procedurave, kërkesa që i është drejtuar Departamentit të BE-së, pika dy e kërkesës, përveç analizimit të aspekteve të procedurave të zhvillimit të procedurës të paraparë në nenin 35 të Ligjit të Prokurimit Publik (në tekstin e mëposhtëm LPP) kërkonte specifikisht edhe analizimin e ekzistimit të kushteve faktike për marrjen e vendimit për përdorim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës. Për këtë pyetje shkresa e KRPP-së e njëjta shkresë d.m.th. e theksuar më lartë 43/2018 thekson si në vijim: “se cilën procedurë dhe në cilin rast do ta përdorë AK-ja është përgjegjësi e plotë e AK-së nëse autoriteti kontraktues konsideron se ka bazë ligjore mund të vazhdohet me procedim të mëtutjeshëm”, lidhur me arsyeshmërinë KRPP nuk mund të jep opinion sepse kjo është përgjegjësi e autoritetit kontraktues të vlerësoj rrethanat që kanë rezultuar deri te marrja e një vendimi të tillë, rrjedhimisht KRPP ka dhënë terma praktik sa i përket vlerësimit të kushteve është përgjegjësi e institucionit të bëj një vlerësim të tillë ka shtuar dëshmitari.

Më tej ka theksuar se duke pasur parasysh që procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës janë shumë të jashtëzakonshme që paraqesin shmangie nga parimet e përmendura, pyetja ishte drejtuar tek vendimmarrësit se a konsideron MIE që e justifikojnë një gjendje të jashtëzakonshme, shmangie nga parimi i cilësisë, konkurrencës dhe transparencës si parime fundamentale të prokurimit publik, d.m.th. pyetjet që ishin adresuar në formë të këtyre alternativave të mundshme konsistonin në atë që kërkohet nga vendimmarrësit MIE që të konsideronin se a i përmbushnin kriteret e procedurës së paraparë në nenin 35 të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe dy alternativave tjera që në bazë të analizimit të kërkesës së ministres për konsulencë ndërkombëtare të parapara në LPP e kanë reflektuar në pikën 3.2 dhe 3.3 të opinionit ku thotë: “përdorimi i nenit 3 të LPP-së dhe alternativa tre “përdorimi i procedurës së kufizuar të prokurimit”, rrjedhimisht në kuadër të secilës alternativë janë parashtruar një sërë pyetjesh të cilat në vlerësimin tim do të konsistonin në qartësimin e dilemave eventuale që mund ti kishin vendimmarrësit. Po ashtu ka theksuar se ashtu siç reflektohet edhe në opinionin procedura e paraparë në nenin 35 është procedurë ligjore, pra ka bazë ligjore.

Sipas dëshmitarit opinioni ka përcaktuar edhe një lloj interpretimi se për çfarë rasti përdoret kjo procedurë, të dhëna këto që i ka marrë nga faqja pesë e rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik është dokument publik që e publikon KRPP-ja. Këto karakteristika të kësaj procedure janë cituar fjalë për fjalë në opinion, d.m.th. nuk ka ndërhyrje nga ana ime. Ky ka qenë sqarim shumë i qartë, çfarë procedure është, për çfarë raste përdoren, kriteret që merren parasysh dhe kjo më ka ndihmu momentin që e kam bërë atë listën e pyetjeve, d.m.th. e kam përmend që kjo procedurë si e tillë është e jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh se kjo procedurë mund të përdoret përjashtimisht cilat janë rrethanat decisive që arsyetojnë këtë procedurë, pastaj kam bërë referim edhe tek mandati institucional i MIE në njërën anë por edhe të MPJ në anën tjetër e cila në bazë të nenit 3.2.a të Ligjit për MPJ dhe shërbimit diplomatik përcakton se ministria zhvillon dhe bashkërendon politikat ndaj shteteve tjera ndërsa në punët e jashtme shpreh dhe mbron interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare në bashkërendim të plotë me ministrinë tjera ka shtuar dëshmitari, duke theksuar se opinionin e tij e kishte përpiluar në formë të pyetjeve të cilat ishin për vendimmarrësit e MIE, pra qëllimi i këtij opinionin ishte udhëzues për të njëjtit.

Dëshmitari ka theksuar se gjatë hartimit të opinionit bazament ka qenë kërkesa për shërbime të konsulencës ndërkombëtare e cila kishte bërë një elaborim të situatës se pse MIE duhet të angazhonte OE Majorelle PR & Events, mirëpo pyetjet e parashtruara në këtë rast vlejné për inicuesit dhe vendimmarrësit që thjesht me i qartësua përtej asaj për përmban kërkesa. Më tej ka theksuar se KRPP-ja sa i përket aspektit procedural ka deklaruar se a janë plotësuar kërkesat ligjore sa i përket aspektit procedural deri më tani është konform kërkesave të nenit 35 LPP-së, kishte konkluduar shkresa e KRPP-së, po ashtu ka deklaruar se është përgjegjësi e autoritetit kontraktues që vetvetiu të bëjë vlerësimin e kriterëve dhe fushëveprimi i opinionit i karakterit ndihmues parasheh një sërë pyetjesh paraprake në tri alternativa të mundshme se si mund të analizohej kjo kërkesë e një prej tyre ishte edhe procedura e nenit 35 të këtij Ligji. Ka shtuar se kërkesa arsyeton se arsyeja pse duhet të angazhohet OE konsiston në atë që janë identifikuar tri sfida kryesore: sfida dhe pengesa në rrugëtimin e Kosovës në BE një prej tyre është edhe mosnjohja nga pesë vendet anëtare të BE-së të cilat dihen kush janë ka deklaruar dëshmitari.

Dëshmitari në fund të dëshmisë së tij ka dëshmuar se ka qenë kryetar i komisionit për vlerësim të tenderit, në lidhje me OE Majorelle PR & Events, duke deklaruar citat *“kanë qenë të specifikuar kriteret çka duhet me shiku në aspekt formal, a i kanë përcjellë dosjen, listen e ekspertëve, fushëveprimin e OE - Majorelle PR & Events dhe rrjedhimisht vlerësimi jonë i aplikimit nga OE - Majorelle PR & Events ka qenë në kontest vlerësimi të këtyre dokumenteve që i përmenda e ku si komision kemi qenë unë, Xh Ma ndërsa i treti anëtar i komisionit nuk më kujtohet ndoshta B V nuk jam i sigurt, dmth si komision kemi vendosur unanimisht që në kontest të kërkesave për dokumentet që OE duhet ti bashkëngjis mungonin CV respektive të stafit që dëshmonin për specializimet e tyre për të ofruar shërbimet e kërkuara nga kjo kërkesë për konsulencë ndërkombëtare. E njëjta në bazë të mbamendjes është edhe e reflektuar në atë formularin e vlerësimit i cili sa e di unë është i plotësuar edhe në gjuhën angleze Conditional Approval – (aprovim i kushteve) me kërkesë specifike që të dorëzoheshin edhe CV që mungonin”*.

3.7. Dëshmitari O B gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me profesion është jurist, ka të përfunduar studimet master, punon në KRPP nga 2013, në dy departamente, fillimisht si zyre ligjore, pastaj në departamentin e monitorimit. Ka shtuar se procedurat e rregullta për prokurim publik e kanë paraparë si procedurë të jashtëzakonshme dhe rregullorja e kaluar dhe tani është neni 51 e parasheh si procedure të jashtëzakonshme që i kufizon transparencën dhe konkurrencën e lirë. Kur aplikohet procedura e negociuar pa publik të kontratës, arsyet

objektive të drejtës pronësore apo intelektuale dhe raste emergjente, këto arsye nënkuptojnë, kur autori i një shpikje, i një sistemi apo softueri është i vetmi prodhues ku nuk e ka dhënë kodin burimor të AK apo ndonjë palë e tretë që ka të drejte, ndërsa sa i përket të drejtës objektive dhe teknike këtu kemi dy rrethana në raste se aktiviteti i prokurimit ka qenë në implementim e sipër dhe ka një nevojë për punë apo shërbime shtesë mbi 10 % rrethanat e orientojnë që me shku për arsye objektive apo lidhje teknike për procedurë të negociuar, ndërsa kur kemi procedura të reja nga fillimi arsye rrethanat objektive realisht nuk kanë ndonjë shpjegim unik, varësisht nga rrethanat ndryshojnë dhe ligji e ka bartur këtë përgjegjësi për shkak se ka qenë e pamundur të merr një organ tjetër për shpjegim të kësaj situate, e ka bart komplet AK përgjegjësinë e argumentimit apo përdorimit të kësaj procedure, si dhe në këto raste neni 87 i LPP par 2.3 e ka paraparë se kurdo që Autoriteti merr vendim atëherë brenda dy ditëve duhet të njoftohet KRPP, i cili realisht është vetëm lloj njoftimi për KRPP se vendimi është marr nga AK. Pastaj emergjenca ekstreme është në rrethana ekstreme si janë forca madhore psh: si pandemia, dhe AK nuk kanë mundësi të bëjnë përzgjedhjen e hapur por shkojnë me procedurën e negociimit e ftojnë një OE apo prodhues për të bërë zgjidhje kur nuk munden me bërë zgjidhje.

Dëshmitari ka dëshmuar se; planifikimi i prokurimit kërkohet në fillim të çdo viti, AK i qet edhe datat se kur planifikohet të realizohet ai aktivitet mirëpo nuk identifikohet procedura që do ta vazhdoj edhe me rastin e procedurave të negociuara varësisht rrethanave që autoritetit ka vlerësuar, si te rasti i emergjencave po dihet, në rastet e mbrojtjes së drejtës së autorit varësisht si e vlerëson Autoriteti dhe çdo procedure e prokurimit duhet të zhvillohet në përputhje me LPP (Ligji i prokurimit publik) rrjedhimisht edhe procedurat e negociimit kërkohen të jepen shpjegime mbi bazën e asaj që ka vendosur me shkuar nëse ka qenë burimore, për shkaqe objektive, apo mbrojtjen e drejtës autorit apo ekskluzive, pra nuk ka ndonjë ndalesë që e rregullon ligji, vetëm për procedurat emergjente mundemi me qenë pa planifikim, si rasti i fundit i pandemisë dhe kanë hy si pa planifikim si dezinfektimi. Lidhur me procedurën e kufizuar të prokurimit ka shtuar se procedura e kufizuar është e karakterit të hapur është procedurë që zhvillohet me dy faza, neni 34 i LPP-së e parasheh dhe mund të zhvillohet në çdo aktivitet të prokurimit kur AK nuk e din dhe në fazën fillestare nuk e dinë saktë çka po donë dhe e bëjnë kualifikimin e OE dhe kërkohet të jetë minimumi tre dhe maksimumi gjashtë OE dhe nëse veç caktohet si numër, nuk caktohen gjitha termat në këtë procedurë, thjeshte kërkohet të behet kualifikimi i OE, pastaj faza e dytë dërgohet dosja përfundimtare dhe behet çmimi për përzgjedhje të OE për kontratë.

Dëshmitari ka shtuar se e ka përgatitur shkresën e parë, për të cilën ka thënë së nuk ka karakter obligativ bazuar në nenin 37/2.3 të KRPP-së duke shtuar se nëse vendos KRPP ta monitoroj nuk ka karakter obligues dhe duke shkuar në këtë frymë nuk kemi parë ndonjë përmbajtje apo analizë në opinion, thjeshtë është adresuar nenit 37 dhe 65 çka thotë ligjit dhe përgjegjësia përfundimtare është e AK. Në lidhje me opinionin e dytë autoriteti pas disa ditësh ka vendosur me aplikuar këtë procedurë, për shkak të mos dualizmit të shkresave unë e kam përgatit prapë të njëjtën shkresë, mirëpo kryesuesi kanë vlerësuar ku thotë; nëse rrethanat e AK qëndrojnë për arsye ekskluzive dhe konfidenciale dhe janë pjekur kushtet, nën përgjegjësinë e AK dhe thotë se për çdo rrethane autoriteti vendos dhe jep shpjegim ka shtuar dëshmitari. Sipas dëshmitarit shkresa e dytë nga KRPP është lëshuar në këtë frymë ngase autoriteti është thirre në të drejtën ekskluzive dhe konfidencialitet të prokurimit ka shtuar dëshmitari.

Në lidhje më opinionet dëshmitari ka shtuar se ishin lëshuar me kërkesë të Sekretarit të Ministrisë në atë kohë D.SH është kërkuar që të jepet një opinion ligjor apo një sqarim në lidhje me përdorimin e procedurës pa publikim të njoftimit për kontratë. Ka shtuar se gjatë tërë

procesit me MIE si autoritet kontraktues nuk kemi vërejtur ndonjë tendencë apo fshehje të informacionit apo dokumenteve nga sekretari i Ministrisë z.Sh, ka qenë një shkresë me 2-3 faqe mbi bazën e asaj çka është vendosur dhe dokumente tjera nuk kemi pasur.

3.8. Dëshmitari A Sh në cilësinë e ekspertit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nga viti 2002 ka punuar në organet e prokurimit publik si ekspert dhe ka pasur një komision për rregullatimin e prokurimit deri në vitin 2010 dhe deri në këtë periudhë ka qenë koordinator për trajtim dhe shqyrtim të ankesave të OE, për një periudhë 1 vjeçare ka qenë auditor i brendshëm, në Mars 2010 është pranuar në Organin Rregullativ të Prokurimit Publik në cilësinë e ekspertit shqyrtues të brendshëm. Që nga viti 2012 është në pozitën e zyrtarit dhe ekspert shqyrtues i brendshëm sipas autorizimeve të brendshme, duke shtuar se ka përvojë në ekspertimin e lendeve që lidhen me prokurim publik pranë gjykatave dhe prokurorive.

Ka shtuar se në cilësi të ekspertit ka trajtuar katër kontrata të cilat i ka nënshkruar MIE për çështje lobimi dhe publikimi, analiza është bërë mbi bazën e materialeve – provave të cilat i janë ofruar nga ana e PSRK-së dhe informatave të cilat i ka marr nga platforma elektronike e prokurimit që lidhen me këto aktivitete, si dhe ka deklaruar se mbetet pranë kësaj ekspertize. Më tej ka theksuar se për çdo aktivitet të prokurimit me rastin e shpenzimit të parasë publike AK janë të obliguara që të iniciojnë procedurat e prokurimit publik duke u bazuar mbi ligjin e prokurimit publik. Pra ekzistojnë një numër i procedurave duke filluar nga procedura e hapur, e kufizuar kuotimi i çmimeve e negociuar pa publikim dhe me publikim. Me rastin e inicimit të një kërkesë për blerje apo furnizim, apo blerje të shërbimeve fillimisht një kërkesë e tillë duhet të miratohet apo aprovohet nga ana e zyrtarit të autorizuar në kuadër të AK-së, pas miratimit të kësaj kërkesë çdo autoritet ka obligim që të plotësoj deklaratën e nevojave rreth disponshmërisë së mjeteve pra është dokument standard, i cili para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit duhet të plotësohet nga zyrtari kryesor administrativ që mund të jetë drejtori, zyrtari i komunës, sekretari i përgjithshëm apo kushdo që është në cilësi të Zyrtarit Kryesor Administrativ (në testin e mëposhtëm ZKA). Më pas kjo deklaratë plotësohet nga njësi kërkuese dhe njëkohësisht nga ZKA (financiar) për të plotësuar dhe konstatuar se ekziston buxheti mjaftueshëm për këtë lloj shpenzimeve. Pas nënshkrimeve përkatëse autorizohet zyra e prokurimit në kuadër të AK që të inicioj procedurat se cilën procedurë duhet të aplikohet është e drejte dhe përgjegjësi e zyrës së prokurimit, pra thjeshtë zyra prokurimit vlerëson se a do të përdorë procedurën e hapur që konsiderohet si një ndër procedurat më transparente për shpenzimin e parasë publike ose procedurën e kufizuar, apo procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë. Për procedurën e kufizuar dhe procedurën e hapur nuk kërkohet të merret asnjë lloj aprovimi apo miratimi paraprak, ndërsa për procedurën e negociuar që konsiderohet një procedurë më jo transparente fillimisht kërkohet të miratohet dhe aprovohet nga ZKA pas një kërkesë të pranuar nga ana e zyrës së prokurimit dhe njëkohësisht pas marrjes së vendimit brenda dy ditëve duhet të njoftohet komisioni rregullativ i prokurimit publik që nënkupton që duhet të jepen arsyet e nevojshme pse AK po e aplikon apo po e zbaton një procedurë të tillë për të arritur një marrëveshje. Pra në kuptim të dispozitave të LPP është e drejtë ekskluzive që aplikimin e procedurës ta zgjedh zyra e prokurimit. Në çdo kontratë publike apo për çdo kontratë publike fillimisht behet njoftimi apo ftesa për oferta, ku ftohen kompanitë apo OE për të marr pjesë në një aktivitet të prokurimit. Ndërsa kur është fjala te procedura pa publikim të negociimit për kontratë nuk kemi njoftim për kontratë por mënyrë të drejtpërdrejtë i dorëzohet ftesa kompanive të caktuara, por fillimisht duhet të merret një aprovim paraprak në mënyrë që me negociuar kushtet e kontratës ka shtuar dëshmitari.

Dëshmitari – eksperti tutje ka deklaruar citat; “për arsye se sipas LPP-së është i bazuar në tre parime bazike, në parimin e transparencës që nënkupton publikimin e njoftimeve, në parimin e

konkurrencës ku gjithë duhet ftuar, një numër sa më të madh të konkurruesve dhe parimin e barabarte apo mos diskriminimit në mënyrë të përmbushet parimi bazik vlera për para që thuhet kosto cilësi. Çdo procedure pas njoftimit janë periudhat e vlerësimit apo pritjes së marrjes së ofertës, periudhat e pritjes së ankimimit bazuar në mjetet juridikë që disponojnë dhe më pas janë afatet kohore për nënshkrim të kontratës. Dhe prokurimi ndahet në tre faza: faza e para kualifikimit, në fazën e tenderimit dhe pas tenderimit që ka të bëjë me nënshkrimin (implementimin e kontratës). Pra sipas rregullave financiare dhe LPP-së secili zyrtar brenda AK ka përgjegjësi të veta nëpër faza. Ky është aspekti procedural. Në rastin konkret pra AK ka ndjekur procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontrate që nënkupton ka bërë një lloj kufizimi të konkurrencës. Me vet faktin kur kemi një minimizim të konkurrencës nënkupton që mos të kemi kualitet të shërbimeve apo furnizimeve. Parimisht në këtë procedure nuk janë ndjekur hapat konkret që i diskutuam për faktin se të drejtën për autorizime dhe caktime të procedurës i takojnë zyrës së prokurimit por jo stafit politik. Përgjegjësitë e zyrës së prokurimit janë të qarta në LPP dhe të ZKA gjithashtu dhe zyrtarit kryesor financiar janë të rregulluara në ligjin financa numër 03L-048.” Ka shtuar se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në shkresa të lëndës të bërë nga MIE, nuk ka hasur as linja buxhetore të sakta për projekt por njëkohësisht nuk kam pasur plan të prokurimit sepse mbi bazën e këtyre aktivizohen edhe autoritetet e prokurimit dhe fillimisht çdo projekt duhet me pas një buxhet ka shtuar eksperti.

Tutje eksperti ka deklaruar se në momentin kur kemi një konkurrence mund të marrim edhe çmime të tregut, momentin kur kufizohet apo minimizohet konkurrenca çmimet mund të jenë të mbi vlerësuar dhe nënvlerësuar se nuk kemi konkurrence nga operatorët që ofrojnë shërbime të tilla. Pra edhe parimisht procedura më e arsyeshme është procedura e hapur dhe në raste të veçanta sipas rregullave që i ka përcaktuar ligji por gjithmonë duke u arsyetuar dhe argumentuara pse AK lejon shmangien e procedurës së hapur apo të kufizuar. Ka theksuar se në rastin konkret nuk janë përmbushur ndonjë nga kushtet apo arsyet objektive, të detyrueshme teknike, e drejta e pronës intelektuale apo për arsye emergjente, për faktin se nuk kemi të bëjmë me të drejtat ekskluzive (artistike) nuk kemi të bëjmë me të drejtën intelektuale apo me çështjen emergjente. Pra edhe dispozita e LPP numër 35/ 2.1.i nuk konsideroj që e justifikon aplikimin e kësaj procedure në rastin konkret. Ka theksuar se në kuadër të autoriteteve është e drejte ekskluzive të përcaktoj procedurën zyra e prokurimit nuk mund të imponohet as nga niveli politik as administrativ. Stafi politik është i emëruari politik duke filluar nga ministri e të këshilltari dhe stafi administrativ është zyrtari publik duke filluar nga ZKA etj. Lidhur me atë se ministrja nuk e kishte një kompetencë të tillë ka shtuar se LPP dhe rregullat financiare dhe ligjet financiare përcaktojnë qarte që përgjegjës për shpenzimin e parasë publike duke filluar nga inicimi deri te nënshkrimi i kontratës janë stafi administrativ. Pra nuk është në mandatin e Ministres të luaj rolin e njësisë kërkuese dhe njëfarë mënyrë të përcaktoj se cila procedure apo me cilin kontraktor apo OE duhet të lidhet kontrata – në asnjë lloj procedure, sepse thjeshtë atëherë nuk kemi të bëjmë me prokurim publik. Ka theksuar se procedura për zyrtar përgjegjës të prokurimit për emrin e një OE fillimisht duhet të miratuar apo aprovuar procedura si e tillë pra thjeshtë duhet të dihen arsyet e devijimit të proceduarave të tjera sepse kjo procedure konsiderohet si procedure e jashtëzakonshme dhe mund të aplikohet në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse e kemi pyetjen për këto shërbime duhet me dite arsyen pse po devijojmë prej procedurës së hapur ku behet ftese dhe nëse kemi të bëjmë me konfidencialitetin dhe sekretit të shtetit ku është dispozitë e veçantë ku i lejon AK me ju shmangur kërkesave të prokurimit dhe aplikimi i procedurës pa publikim. Eksperti ka theksuar se AK-së i lejohej të anulohet një aktivitet të prokurimit në çdo kohë para fazës së tenderimit derisa të dorëzohen ofertat. Gjate fazës së tenderimit në kuptim të nenit 62 të LPP duhet të plotësohen një sërë kërkesash dhe kur kemi të bëjmë me nënshkrimin dhe për dhënien e kontratës anulimin e aktivitetit të prokurimit konsiderohet pak më kompleks për vet faktin se qoftë me të drejte apo

pa të drejte janë kaluar të gjitha proceset dhe tani pyetja konkrete për me shfuqizuar se kontrata ende nuk është nënshkruar apo për tu anuluar një aktiviteti i prokurimit është një përgjegjësi komplekse sepse parimisht janë aprovuar gjitha hapat e nevojshëm me të drejte apo pa të drejte.

Lidhur me vendimin për shkëputje të kontratës të datës 11.11.2019 ka shtuar se nga ana e sekretarit të përgjithshëm të ministrisë kompania në fjalë njoftohet për pezullim të aktiviteteve të shërbimeve me datë 09.09.2019 dhe me 10.10.2019 përmes e-mailit njoftohet për shkëputje të kontratës ndërsa me datë 11.11.2019 nxirret vendim për shkëputje të kontratës, ku sipas këtij vendimi pika II thuhet se shkëputja e kontratës për nr. të prokurimit 218193035215 është efektive nga data 07.09.2019 çka do të thotë sepse jemi në muajin njëmbëdhjetë edhe shërbimet nëse janë realizuar paraprakisht konsiderohet se autoritetit nuk do të ketë obligime dhe sigurisht kjo ka faturuar shërbime që janë në përputhje me kushtet e kontratës. Ka shtuar se Departamenti i Drejtës Evropiane ju ka tërhequr vërejtjen paraprakisht ku ka thënë këto kontrata në nivel me institucionet se është në kompetence të MPJ sepse është përgjegjësi e tyre dhe mënyrë të mos dalim jashtë kompetencave të MIE madje edhe për procedure ka tërhequr vërejtjen ku ka lëshuar interpretim ku këto shërbime të tilla të konsulencs apo integritimeve duhet paraprakisht të shtjerrën mundësitë tjera ligjore nëse konsiderohen shërbime sekrete në kuptim të nenit 3 të LPP në mënyrë të nënshkruhen kontrata bilaterale në mes të kompanive apo të udhëhiqet një procedurë tjetër e kufizuar ku i hap mundësi konkurrencës dhe vetëm operatorët e kualifikuar të hyjnë në marrëveshje kontraktuale në përputhje me procedurën e kufizuar. Si vërejtje të tillë në bazë të asaj që e kam parë është injoruar krejtësisht nga ana e vet ministres ka shtuar ekspertin. Ka shtuar se ka qenë i pajisur me shkresa vetëm nga prokuroria dhe si pjesë e dokumentacionit të prokurorisë letër informimi i datës 04.05.2018 të dërguar nga sekretari i MIE z.Sh drejtim të Agjencionit kundër Korrupsionit dhe në atë shkresë nga KRPP kane kërkuar një opinion edhe nga AKK madje edhe nga zyra kombëtare e auditimit është kërkuar një opinion, ku zoti Sh ka kërkuar se a është e drejtë që të aplikohet një procedurë e tillë. Më tej ka theksuar se KRPP nuk ka dhënë vlerësim për procedurë, KRPP ka dhënë mendim deri në nisje të procedurës, e jo për fazën e tenderimit se a është procedure adekuate dhe ka lënë në përgjegjësi të AK dhe nuk ka dhënë mendim të prere që bënë apo nuk bene por e ka lënë në përgjegjësi të AK. Ndërsa në kuptimin procedural ka thënë se ka pranuar një njoftim dhe këtë kontest është thirrur se aspekti procedural ka qenë në rregull.

Eksperti gjatë dëshmisë së tij ka potencuar se kontratat me kompanitë Franceze nuk dihet se çfarë shërbime ka ofruar, asnjëherë nuk është vlerësuar as kontratën e parë as ne kontratën e dytë performanca e kësaj kompanie, cilat janë benefitet e kësaj kontrate, a ka ofruar për ministrinë dhe sa i ka ndihmuar institucionet drejtë proceseve integruese, madje kemi rast kur komisioni për pranimin e këtyre shërbimeve ka hezitur që të pranojë shërbimet, respektivisht faturat për shërbimet e pranuar sepse nuk është ditur për çfarë lloj shërbimesh është fjala dhe çka është përmbushur me faturën e pranuar.

3.9. Dëshmitari V J gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se; studimet i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Shkenca Politike, pastaj studimet master në Ekonomi Politike në Britani të Madhe dhe tani është në studime të doktoratës në Suedi. Punën e ka filluar në vitin 2018 në MIE për tre vite e kemi pas obligim me punuar në administratën publike si pjesë e reformimit të administratës publike ka shtuar dëshmitari. Në MIE e kam pas pozitën e zyrtarit të lartë për kritere ekonomike dhe treg të brendshëm ku jemi marr me përafrimin e politikave shtetërore të Kosovës me akte te EU-së për disa kapituj specifik që kanë pas të bëjë me tregun e brendshëm dhe konkurrencën.

Ka shtuar se në lidhje me rastin konkret ka qenë i përfshirë në proces si anëtar i komisionit në pranimin e shërbimeve dhe faturës për muajin tetor të vitit 2019, shqyrtimin e kemi bërë në dhjetor të 2019 dhe puna jonë ka qenë me shikuar shërbimet nga OE që janë bërë në tetor 2019. Më tej ka theksuar se citat; “Komisioni është themeluar në javën e dytë të dhjetorit 2019, kam qenë unë, V H, B X. Përgjegjësisë kane qenë me pare përputhshmërinë e aktiviteteve që kanë qenë të OE dhe shërbimet që janë kryer nga OE në tetor të 2019, me shqyrtuar gjithë dokumentacionin me bere pyetje dhe nëse kemi pas nevojë diçka për informacione shtesë. Komisioni është mbledhur me 16.12.2019 kur e kemi pranuar dokumentacionin që është dorëzuar, fillimisht kemi qenë të kontaktuar nga Gëzim Dushi që ka qenë si menaxher i kontratës dhe na ka dorëzuar dokumentacionin, dokumentacioni ka qenë fatura 28 mijë euro dhe raportin që e ka dërguar OE për periudhën 1 tetor 2019 deri 31 tetor 2019. Raporti që e kemi pranuar ka qenë raport shumë i thjeshte rreth katër faqe dhe ne si komision e kemi shqyrtuar këtë raport dhe nuk jemi bind nga ajo që kemi parë në raport, raporti ka përmbajtur disa screen shot, apo fotografi të marra direkt nga Web faqet e mediave Franceze kinse OE ka bërë vetëm monitorimin e atyre mediave, pra aty janë renditur titujt e artikujve që kanë pas të bëjnë me Kosovën në tregun medial të Francës dhe në mënyrë shumë të përgjithësuar janë dhënë disa detaje të tjera që nuk kane qenë bindëse për neve si komision për me dhënë pëlqimin për ekzekutimin e pagesës, psh: për të fundit ka pas du ose tre fjali se OE ka realizuar takime me disa zyrtar që nuk i është përmendur emri i zyrtareve e as çfarë pune kane kryer punëtorët e OE me këta zyrtar dhe ne e kemi shfrytëzuar të drejtën si komision dhe kemi kërkuar informacione shtese nga OE ku kemi dashtë me bere lidhjen me shërbimet që është dashur ti kryenin ata dhe ato që i kanë kryer faktikisht. Pas dy-tre ditë kemi marr një email nga një përfaqësuesi i këtij OE përmes menaxherit të kontratës Gëzim Dushi ku përsëri ka dështuar OE me sjell diçka të re dhe fakte bindëse për aktivitetet që ata kanë pretenduar që i kanë kryer për periudhën Tetor 2019. Unë si anëtar i komisionit kam biseduar me dy koleget e mi që kane qenë anëtar të komisionit dhe me menaxherin e kontratës dhe sugjerimi im ka qenë nëse pajtohen edhe dy koleget që të marrim vendim apo ta shkruajmë raportin refuzues për ekzekutimin e pagesës për shkak se OE kishte dështuar me ofruar fakte bindëse se çfarë pune ka kryer për atë periudhe. Pas bisedës se dy kolegeve dhe me menaxherin e kontratës vendosem me ja dhënë edhe një mundësi OE që me dëshmuar punën e tij dhe me 23.12.2019 e kemi marr një email tjetër nga OE edhe me ju tregu të drejtën unë u pata skandalizuar me qasjen e OE karshi komisionit dhe menaxherit të kontratës për shkak se nuk më është dukur raport normal mes një institucioni dhe OE për punën që e ka kryer, dhe kjo emaili i dytë ka qenë email përgjithësues nuk ka pas asgjë bindëse dhe me habi përfaqësuesi i OE shprehet se kështu ka qenë edhe më parë dhe nuk e di pse tash po ka pyetje që po janë shumë më specifike lidhur me aktivitetet që është dashur me i kryer. Ne mbledhemi me 24 dhjetor me anëtar si komision dhe unanimisht vendosim të përpilojmë raportin që do ju dorëzohej sekretarit të MIE z.K.C dhe ne në atë raport i listojmë gjitha arsyet se pse pagesa për këtë OE për periudhën që ne e mbulonim nuk duhet me u realizuar dhe të njëjtin ja dorëzoj edhe në mënyrë elektronike menaxherit të kontratës me idenë që ai pastaj të ja përcjelle palëve relevante, si fillimisht sekretarit dhe gjithë stafit që ka qenë i përfshirë në menaxhimin e kësaj kontrate. Unë me të njëjtën datë siç ka qenë edhe praktika gjithmonë, kam kërkuar pas disa orësh nga menaxheri i kontratës protokollimin e atij vendimi dhe dërgimin e të njëjtit në format elektronik tek ne, te sekretari dhe të gjithë kolegeve që kanë qenë të involvuar në këtë kontratë dhe unë nuk kam pranuar asnjë njoftim nga menaxheri i kontratës. Pse nuk është protokolluar fillimisht vendimi i komisionit dhe pse nuk është dërguar te gjithë të tjerët dhe deri me datë 30 dhjetor nuk jam marr më me punën e kontratës se e kemi dorëzuar vendimin, e kemi kërkuar protokollimin dhe kemi menduar se puna jonë është kryer deri me datë 30 dhjetor kur kam marr një thirrje nga kolegja e financave që ka qenë përgjegjëse për ekzekutimin e pagesave, ajo ka qenë në dijeni se unë kam qenë njëri nga anëtarët e komisionit për pranimin e shërbimeve dhe ajo më pyeti



nëse komisioni ka marr ndonjë vendim dhe ajo nuk e ka ditur se komisioni rreth një jave me pare ka marr vendim refuzues për mos ekzekutimin e pagesës dhe unë e kam njoftuar atë se komisioni në mënyrë unanime ka marr vendim refuzues për ekzekutimin e pagesës dhe dosja nuk është e kompletuar pa një vendim pozitiv nga komisioni. Pas disa orës me datë 31 dhjetor e njëjta kolege znj.S K e dërgon një email te zyrtari i prokurimit te z.F.M neve na vendos CC, edhe sekretarin e vendos në CC, ku e njofton z.M se ajo nuk mund të procedoj me ekzekutimin e pagesës për shkak se dosja sipas rregullores financiare numër 01/2013 neni 22 i kësaj rregullore kërkon që para ekzekutimit të pagesës dosja duhet të ketë edhe raportin për pranimin e mallit apo shërbimit. D.m.th. zyrtarja në fjalë ka pranuar dosje për shërbim të pagesës pa ju bashkangjitur raporti i datës 24 dhjetor dhe ajo i fton që të kompletohen gjitha hapat procedural në përputhje me kuadrin ligjor për mundësinë e realizimit të pagesës. Mua aty më kanë hy dyshimet se këtu ka interesa më të mëdha se ato që shiheshin shumë sipërfaqësisht përmes këtyre raporteve, ishin shumë banal nga ana e OE edhe në atë moment kam vendosur me u kyçur dhe me u kujdesur për fatin e kësaj pagese dhe jam interesuar shumë se si po përfundohet tutje për shkak se kam pas dyshime që mund të ekzekutohet pagesa edhe pse ne si anëtar kishim marr vendim për mos ekzekutim të pagesës. Pastaj me 9 Janar ish sekretari i MIE e dërgon një email në drejtim të menaxherit të kontratës G D ku ishim edhe ne të tjerët në CC dhe d.m.th. e vazhdon komunikimin që e kishte filluar kjo zyrtarja e financave dhe në atë email që ja dërgon z.D meqenëse çështja ende nuk ka përfunduar e ekzekutimit të pagesës i lutet menaxherit të kontratës OE dhe të mblidhet prape komisioni për pranimin e shërbimeve dhe siç ka thënë në atë kohë “në mënyrë që të kemi mundësi ti realizojmë obligimet tona përndryshe çdo vonesë shprehet ish sekretari mund të na dërgoj në situata penalizimi nga OE”, pastaj unë me të njëjtën datë me 9 Janar detyrohem me shkruar një email në drejtim të ish sekretarit z.Cj ku ja rikujtoj se komisioni për vlerësimin e kontratës ose pranimin e shërbimit i ka konsumuar gjitha procedurat për me kërkuar informacione shtesë nga OE dhe duke qenë se OE kishte dështuar më shumë se një here me dërguar informacionet që ja kishim kërkuar është jo logjike dhe absurde të kërkohej diçka që supozohej të kryhet në tetor të vitit 2019, unë i them se është jo logjike dhe absurde të kërkohej diçka që nuk është kryer dhe e njoftoj ish sekretarin Sh që vendimi i komisionit ishte i pakthyeshem dhe nuk mundet asnjë raport tjetër me ju mbi vendos këtij raporti. Unë i them që komisioni me tre anëtar që isha edhe unë pjesë nuk mundet me u angazhuar lidhur me dështimin e OE për mi faktuar shërbimet që supozohej me i kryer, të njëjtën kohë unë e njoftoj sekretarin që vendimi i komisionit ende nuk është protokolluar edhe pse kërkesa ka qenë me 24 dhjetor dhe i them se kanë kaluar më shumë se dy jave që ky raport i komisionit nuk i është dorëzuar palëve relevante, dhe në fund e njoftoj ish sekretarin meqenëse ai ka fol për penalizime unë i sugjeroj ndoshta është e rrugës që ne si palë e dëmtuar si institucion publik ti shqyrtojmë mundësinë e kërkitimit të përgjegjësive ndaj OE sepse ishin ata që kane dështuar në përmbushjen e obligimeve kontraktuale dhe në vend te presim që OE të inicioj procedure te arbitrazhit më mirë kishte me qenë që ne te ishim në ofensivë. Pas atij emaili nuk kam pranuar as nga z.D e as nga sekretari Cj dhe unë nuk di nëse ai raport i komisionit nëse është protokolluar se nuk është dërguar asnjëherë dhe shumë më vonë e kam marr vesh se pagesa më duket ende nuk është paguar për këtë edhe pse qe një vit e gjysme nuk kam ndonjë kontakt me pyetur dikend se a është realizuar pagesa apo jo. Ndoshta për fund kur ju thash që pas 30 dhjetorit fillova me u marr prape me këtë punë se fillova me dyshuar lidhur me qëllimet e kësaj kontrate është se herën e dytë kur e kemi pyetur OE për punët që i ka kryer në muajin tetor ata veç se e kanë përsëritur informacionin që e kanë dhënë në raportin e parë dhe e kanë bashkangjitur një dokument që mua më është dukur tepër interesant dhe nuk ka qenë në raportin e pare dhe ai dokument mbanë datë 20.09.2019 d.m.th. data është jashtë periudhës që ne si komision është dashur me shqyrtuar dhe nuk është për periudhën tetor dhe dokumentin që na kane dërguar neve është Note që ata pretendojnë se ja kanë dërguar ish ambasadorit në Francë z.Q G në këtë Note (shënim) që e mbanë emrin

*Analizë e rrugës së Kosovës drejte integritit në BE jepen shumë informacione të përgjithësuara ashtu që edhe për një të interesuar mesatar të integritimeve Evropiane nuk është që diçka i kish ra e re dhe çka më ka ra mu në sy ne faqen e dy të këtij raporti që këta pretendojnë se ja kanë dërguar z. Q G ata flasin për një marrëveshje të mundshme mes Kosovës dhe Serbisë dhe në atë kohë diskutoheshin shumë ideja të korigjimeve të kufijve. Aty përmendet që janë rihapur diskutimet për një marrëveshje të mundshme të Kosovës dhe Serbisë dhe përmendet zgjidhja e modifikimeve territorial në mes dy shteteve. E veçanta e këtij raporti thuhet se kjo çështje pra çështja e modifikimit mes Kosovës dhe Serbisë është duke u keqkuptuar nga politika Franceze dhe mediat Franceze edhe pak më poshtë thuhet që pozicioni i Kosovës dhe ndryshimi i kufijve mundet me i shërbyer paqes në mes të dy shteteve, po has në vesh të shurdhër. Pra në këtë pjesë ata lëshohen në vlerësime normative por pozicioni i Kosovës në atë kohë nuk ka qenë për ndryshime të kufijve se kane qenë dallimet mes ish presidentit dhe ish kryeministrit, dhe ideja që po keqkuptohet dhe keqinterpretohet ka nënkuptuar që ky keqkuptim dhe keqinterpretim mu adresuar. Mua këtu më kanë filluar dyshimet se kjo kontratë nuk është bere për atë që thuhej në kontratë por është bere për qëllime të tjera dhe se duke qenë se nuk e kam pranuar raportin e komisionit te protokolluar dhe arkivuar dhe kam pritur tre jave a po vjen raporti i komisionit në fund të janarit apo fillim të shkurtit të 2020 unë shfrytëzoi të drejtën e sinjalizimit dhe e raportojo rastin në AKK. Një zyrtar aty e ka marr rastin kemi biseduar në lidhje me këto që i thash më lartë dhe nuk e di se si ka shkuar procedura brenda institucionit. d.m.th. kjo është pak a shumë angazhimi im në krejt këtë kontratë”. Ka theksuar se si anëtar i komisionit nuk i është nënshtruar dhe nuk ka pas presion prej asnjërit nga zyrtaret.*

#### 4. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

- Kërkesa e të pandehurës Dh.H me nr.prot.01/873-1-2018 e dt.11.05.2018 dhe kërkesa e datës 21.02.2019 nr.01/257-1-2019.
- Kërkesa e të pandehurës Dh.H me nr.prot.667-1-2019 e dt.24.04.2019.
- Kërkesa e të pandehurit F M, nr.874-1-2018 e dt.11.05.2018 dhe kërkesa nr.prot.268-1-2019 e dt.22.02.2019.
- Kërkesa e të pandehurit F.Mnr.765-1/2019 dt.07.05.2019.
- Kërkesa autorizimi dhe deklarata për ZKA e datës 22.02.2019 nënshkruar nga i pandehuri K.C.
- Kërkesa, autorizimi dhe deklarata për ZKA të datës 06.05.2019 nënshkruar nga i pandehuri K.C.
- Kërkesa me nr.874-1-2018 e dt.11.05.2018 dhe kërkesa e dt.29.05.2019 me nr.prot.1006-1-2018 të nënshkruara nga i pandehuri D.SH.
- Kontrata me titull “Shërbime të konsulences ndërkombëtar për nevojat e MIE-së” në vlerë prej 180,000.00 €, me nr. të prokurimit 2018-19-680-2.1.5 me OE “Majorelle PR & Events” datë 17.08.2018.
- Kontrata me titull “Shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së” në vlerë prej 168,000.00 €, me nr. të prokurimit 218-19-680-2.1.5 me OE “Majorelle PR & Events” datë 28.03.2019.
- Kontrata me titull “Shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së” në vlerë prej 171,000.00 € me nr. të prokurimit 218-19-016/215 me OE “Madison Global Stratgies LLC” datë 17.06.2019.
- Ekspertiza e ekspertit financiar dhe të prokurimit A Sh e dt.28.05.2021.

- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës i dt.22.04.2010, nr.6/121 dhe vendimi i komisionit disiplinor për pozita të nivelit të lartë drejtues me nr. prot. 575/2 të dt.22.05.2020.
- Opinioni i Departamentit të Drejtësisë BE-së, në kundër të MIE-së i dt.25.05.2018 nr. prot. 990-2018.
- Opinionet e KRPP-së dt.22.05.2018 nr. prot.43/2018 dhe datë 28.05.2018 nr. prot.46/2018
- Fatura e dorëzuar në MIE nga OE “Marojelle PR & Events” dhe atë fatura me nr.2019/124, nr. Prot. Dp/158 dt.19.07.2019, Fatura 2019-83 nr. prot Dp/99 dt.15.06.2019, Fatura 2019-189 nr. prot Dp/230 dt.25.10.2019, Fatura 2019-102 nr. prot Dp/132 dt.26.06.2019, Fatura 2018-150 nr. prot Dp/181 dt.05.10.2018, Fatura 2019-149 nr. prot Dp/178 dt.23.08.2019, Fatura 2019-2010 pa nr. prot, Fatura 2018-189 nr. prot Dp/265 dt.21.12.2018, Fatura 2019-16 nr. prot Dp/53 dt.22.03.2019, Fatura 2018-206 nr. prot Dp/13 dt.05.02.2019, Fatura 2018-171 nr. prot Dp/2013 dt.13.11.2018.
- Njoftimi nga takimi i komisionit i datës 24.12.2019 për ish sekretarin e Përgjithshëm tani të pandehurin K.C nga anëtarët e komisionit në përbërje prej B X, V J dhe V H lidhur me vendimin faturën e muajit tetor 2019.
- Emaili i dërguar nga V J i datës 09.01.2020 për të pandehurin K.C ku e njofton lidhur me mos protokollimin e vendimit të marr nga ana e tyre si komision dhe njëkohësisht i sugjeron që MIE si palë e dëmtuar mund të kërkoj përgjegjësi nga OE Majorelle PR & Events për mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale.
- Emaili i dërguar nga V J i datës 23.12.2019 ku e njofton menaxherin e kontratës Gëzim Dushi se kishin pranuar përgjigjet e kërkuara nga OE Majorelle PR & Events dhe se ato për të ishin të pamjaftueshme, jo bindëse dhe ofenduese si shërbyes civil i nomimuar në komision për të mbrojtur interesin publik.
- Procesverbali i pranimit të shërbimeve i datës 03.12.2019 lidhur me pranimin e faturës 2019-189 në vlerë prej 28,000.00 € e që në bazë të numrit të faturës rezultoi të jetë fatura e muajit tetor 2019 të cilën paraprakisht kishin refuzuar ta pranonin komisioni i përbërë nga B X, V J dhe V H, ndërsa sipas këtij procesverbali rezultoi se edhe dëshmitarja V H kishte abstenuar.
- Përshkrimi i fushe veprimtarisë së OE Madison Global e datës 04.02.2023.
- Kontrata për shërbime e lidhur ndërmjet Ministrisë së Integritetit Evropian në një të anë dhe Madison Global Strategies L.L.C në anën tjetër e cila përmban 12 faqe gjithsej.
- Kontrata për shërbime e lidhur ndërmjet Ministrisë së Integritetit Evropian në një të anë dhe Marojelle PR & Events në anën tjetër e cila përmban 13 faqe gjithsej.
- Artikulli në gazetën Telegrafi i dt.10.04.2019 me foton të ministres Dh.H dhe MPB – Francës me titullin “H takon ministrin e brendshëm të Francës dhe dakordohen për bashkëpunim në fushën e sigurisë” nga faqja e kryeministrit të Kosovës “Paris 1 Korrik 2019”.
- Artikulli me foto dhe kontaktet nga zyra e kryeministrit të RKS-së me titullin “Kryeministri H u prit nga ministri i brendshëm i Francës Christophe Castaner” kjo është 1 (një) vit pasi që kryeministri është arrestuar në Francë dhe është mbajtur një kohë nga autoritetet atje.
- Gazeta projekti pra për takimin tjetër në foto ku shihet Kryeministri – R H me presidentin e Francës – M, dhe Kryeministrin e Shqipërisë – R me titullin “M i tha H, pezullo taksën në do të heqim vizat për 4 muaj”.
- Prova tjetër nga vet portali qeveritar nga MIE Interviste e MIE-së për të përditshmen Franceze L’Opinion “Kosova troket në derën e BE-së”. Nga DË “Ministrja Kosovare në tur lobimi për liberalizimin e vizave” nga zyra e kryeministrit nënshkrimi i

marrëveshjes foto nuk shihet vetëm teksti “Kosova dhe Franca thellojnë bashkëpunimin bilateral”.

- Portali Ekonomia këtu thotë se “Kosova dhe Serbia angazhojnë kompani lobimi në SHBA”. Radio Evropa e lirë “SHBA thirrje BE-së që ti liberalizojë vizat me Kosovën”.
- Portali blic “SHBA presion Bashkimit Evropian Mbani premtimin – liberalizoni vizat për Kosovarët”
- Artikulli nga Radio Evropa e lirë “A ka Kosova strategji për tu ballafaquar me lobimin e Serbisë”.
- Opinionet e KRPP-së, të datës 22.05.2018 me nr. prot.43/2018 dhe të datës 28.05.2018 me nr. prot.46/2018.
- Raporti final i DAB me Nr.prot.3077-1-2018 i datës 05.12.2018 për Divizionin e Prokurimit.
- Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Integritetit Evropian Prishtinë, qershor 2019, i publikuar edhe në web faqen e tyre zyrtare (<http://zka-rks.org>).
- Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Integritetit Evropian, Prishtinë, korrik 2020, i publikuar edhe në web faqen e tyre zyrtare (<http://zka-rks.org>).
- Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit për vitin fiskal 2018 i MIE, dërguar më datë 19.01.2018 në Autoritetin Qendror të Prokurimit - AQP dhe Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit për vitin fiskal 2019 i MIE, dërguar më datë 20.02.2019 në AQP.
- Komisioni për zhvillimin e negociatave me nr.prot.871-1-2019, i datës 22.05.2019.
- Kërkesat e aprovuara nga ZKA-SP me nr. prot. 874-1- 2018, te dt.11.05.2018; kërkesa nr.prot.268-1-2019, e dt. 22.02.2019 dhe kërkesa e dt.07.05.2019 me nr.prot.765-1-2019.
- Komisioni i hapjes dhe i vlerësimit me nr. prot.1021-1-2018 i datës 01.06.2018 dhe E-maillet e datës 21 dhe 22 qershor 2021 nga SP D.SH drejtuar te pandehurit F.M dhe i informuar për të gjitha këto zhvillime ka qenë në Cc edhe dëshmitari D A.
- Komisioni i Vlerësimit-negocimit, nr.prot.371-01- 2019, dt.06.03.2019.
- Vendimi i komisionit me nr.prot.1021-1-2018, i dt.01.06.2018; Vendimi i komisionit me nr.prot.371-1-2019, i dt.06.03.2019 dhe Vendimi i komisionit me nr.prot.871-1-2019 i dt.22.05.2019.
- Shkresa me titull “Pezullimi i aktivitetit prokurimit” e z. Sh drejtuar z. M, me nr.prot.974-1-2018, e datës 24.05.2018.
- Shkresa me titull “ Kërkesë për shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së” e z. Sh drejtuar znj. H, me nr.prot.1004-1-2018, e datës 29.05.2018.
- Shkresa me titull “ Kërkesë për shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së” e znj. H drejtuar z. Sh, me nr.prot.1005-1-2018, e datës 29.05.2018.
- Shkresa me titull “ Kërkesë për shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së” e z. Sh drejtuar z. Mu , me nr.prot.1006-1-2018, e datës 29.05.2018.
- Kërkesa e z.D.SH drejtuar Agjensionit Kundër Korrupsion e datës 17.05.2018 me numër protokolli 915-17-2018;
- Kërkesa e datës 23.05.2018 për opinion ligjor lidhur me përdorimin e nenit 35.2.1(i) të LPP-së – Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, e dërguar nga z.D.SH në cilësi të ...-së në drejtim të z.D A, u.d. Drejtor i Departamentit të së Drejtës së BE-së;
- Kërkesa për opinion ligjor drejtuar KRPP-së nga z.D.SH e datës 24.05.2018 me numër protokolli 975-1-2018 (Kërkesa e dytë);
- Përgjigja e Agjensionit Kundër Korrupsion e datës 28.05.2018, e dërguar në formë elektronike përmes postës elektronike (e-mail) tek z. F M, z.D.SH dhe znj.Dh H.
- Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, e evidentuar me numër A.nr.1212/2020, të datës 24.07.2020.

- Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë AA. nr. 480/2020, të datës 27.08.2020.
- Vendimi për sistemimin e përkohshëm të ish MIE-së, me numër 10/59, datë 2021
- Refuzimi për pagesën e faturës datë 09.12.2019,
- Raporti nga vizita e Punës në SHBA kontrata e Lobimit me MGS, nëpërmjet e- mail, në dijeni të ish z.B R, ish ministër i MIE,
- Vendimi për shkëputjen e kontratës me Nr.Prot 1930-1-20 datë 11.11.2019
- Shikimi i Fotografisë ku eksperti Agim SHEQIRI, ekspert i prokurorit dhe financiar shihet me Burim Guri, nënshkruar i vendimit për shkëputjen të kontratës me numër të Prot.1930-1 20, datë 11.11.2019,
- Komunikimi zyrtar përmes e-mail, lidhur me Kontrata e operatorit Ekonomik MSG.
- Vendimi i Ministres së MIE me numër protokollit 2264-1-2018, dt.10.08.2018;
- Vendimi i U.D ..., nr. protokollit 225-1-2018, dt.09.08.2018; dhe
- Marrëveshja e nënshkruar në mes Sekretarit të Përgjithshëm të MKK dhe U.D ..., me nr. Protokollit 2244-2-2018, dt.07.08.2018.

## 5. Mbrojtja e të pandehurve

5.1. Të gjithë të pandehurit kanë shfrytëzuar të drejtën të mbrohen në heshtje duke u konsultuar paraprakisht me mbrojtësit e tyre.

## 6. Fjala përfundimtare e palëve

6.1 Prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Dren Paca në fjalën përfundimtare në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.04.2023 ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim me datë 24.04.2023, me një precizim tek pjesa e fundit respektivisht faqes njëmbëdhjetë pasusi i parafundit, aty ku është thënë “me dënim me burgim prej 5 vite” duhet të jetë “për secilin veç e veç” ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar prokurori ka theksuar se të pandehurit kishin qenë personat kompetent dhe përgjegjës për inicimin e procedurave të prokurimit, përcaktimin e llojit dhe arsyeshmërisë së procedurës së prokurimit që duhej aplikuar si dhe eventualisht përcaktimin e operatorëve me të cilët duhej hyrë në negociata, mirëpo që të katërt duke e shfrytëzuar detyrën e tyre zyrtare në vend se të refuzojnë kërkesat e të akuzuarës Dh H, ata i aprovojnë ato edhe pse ishin në dijeni se ajo nuk ishte kompetente që të ndërmerre asnjërin nga veprimet e lartcekura dhe se asnjë nga kushtet e kërkuara për aplikim të procedurës së negociuar nuk ishte plotësuar, përkundrazi që të katër së bashku në periudha të ndryshme të cekura si në aktakuzë kishin aprovuar kërkesat e të akuzuarës H dhe i kishin hapur rrugë nënshkrimit të kontratave me operatorët ekonomik në fjalë sikurse që kishte kërkuar e pandehura H. Po ashtu me veprimet e lartcekura të pandehurit secili veç e veç kryen veprën penale që ju ngarkohet, në rastin e parë e akuzuara H tejkaloi kompetencat ligjore, në rastin e dytë të akuzuarit Sh, C, O dhe M kanë mundësuar tejkalimin e kompetencave, ata që të gjithë së bashku ia mundësuan përfitimin pasuror Operatorëve Ekonomik “Majorelle PR & Events” dhe “Madison Global Strategies LLC” në vlerën e tërësishme kontratave apo 500,232.00 euro dhe po ashtu i kishin shkaktuar dëm në kuptim të cenimit të drejtës së konkurrimit edhe operatorëve tjerë ekonomik potencial të cilët në rast se nuk do të aplikoheshin procedura e negociuar sipas udhëzimeve të akuzuarës H, do të mund të konkurrinin në këtë proces dhe ta gëzonin të drejtën e tyre elementare dhe kushtetuese dhe atë të konkurrencës. Më tej ka theksuar se gjykata duhet pasur parasysh se edhe sikur KRPP apo kushdo tjetër të

konstatonte se eventualisht ishin plotësuar kushtet për aplikimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të parapara në nenin 35 par.2, kjo gjë përsëri nuk i amnistion të pandehurit pasi që neni 35 nuk i jep kompetencë ministres, prandaj fakti se edhe proceduralisht është gabuar mund të merret vetëm si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurve. Gjithashtu të pandehurit me rastin e dhënies së mbrojtjes së tyre në prokurori në asnjë moment nuk kanë qenë në gjendje ta provojnë se ministrja tani e akuzuara H kishte kompetencë ligjore që ta inicioje procedurën e prokurimit, përcaktonte atë dhe të përcaktonte emrat e operatorëve ekonomik me të cilët duhej të lidheshin kontratat, ata kryesisht janë munduar të arsyetohen duke thënë se veprimet i kishin bërë për të mirën e vendit apo në rastin e të pandehurit F.M se kjo kishte qenë kërkesë e ministres. Po ashtu nga rrethanat faktike, fakti se kompanitë “Majorelle PR & Events” dhe “Madison Global Strategies LLC” dhe punët që do të kryheshin nga këto kompani ishin përcaktuar paraprakisht nga e pandehura H, pa asnjë lloj rekomandimi dhe pa negociuar me asnjë operator tjetër, pa bërë studim apo hulumtim të tregut, është tregues i qartë se të pandehurit me dashje ia mundësuan operatorëve të lartcekur përfitimin apo shpërblimin me kontratë, ngase po të mos kishin dashur shpërblimin me kontratë pikërisht të këtyre operatorëve ministrja do të kishte paraqitur nevojat e saj dhe të ministrisë dhe do të lejonte personat tjerë kompetentë që të merreshin me procedurat tjera, mirëpo ajo vet duke tejkuluar kompetencat e saj ligjore inicioi procedurën, e përcaktoi llojin e procedurës dhe përcaktoi emrat e kompanive me të cilët duhej lidhur kontratat, të cilën procedurë pastaj pandehurit tjerë e aprovuan dhe e shtynë përpara deri në nënshkrimin e kontratave dhe realizimin e pagesave. Andaj, nga dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimet gjyqësore si dhe nga provat e administruara, kemi arritur që të argumentojmë këtë aktakuzë me të cilën i kemi ngarkuar të pandehurit përtej dyshimit të bazuar mirë, andaj i propozojnë gjykatës që të pandehurit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, respektivisht t’iu shqiptoj dënim me burgim prej 5 vitesh i cili eventualisht do të rritej ose zvogëlohej varësisht nga rrethanat rënduese dhe lehtësuese që do ti gjej gjykata si dhe dënimi me gjobë dhe njëkohësisht t’i shqiptoj edhe dënim plotësues “Ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës”, ka përfunduar prokurori në fjalën e tij përfundimtare.

6.2. Mbrojtësi i të pandehurës Dh.H– av.Florent Latifaj në fjalën e tij përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 24.04.2023 ka deklaruar se citat: *në mungesë të tërësishme të fakteve dhe provave për çka do të duhej të disponoj një prokurori dhe një prokuror, në fjalën përfundimtare të prokurorit dëgjua thashetheme për të mos thënë përralla të rrugëve të Prishtinës, duke ja dhënë vetës të drejtën që nga cilësia e organit të akuzës me na treguar marrëveshjen e Washingtonit, kush e ka nënshkru, kush e pruni atë marrëveshje – njohjen dhe kush ja zbardhi fytyrën këtij vendi”.*

Mbrojtësi av. Florent Latifaj në fjalën e tij përfundimtare ka paraqitur vërejtjet e tij në dëshmitarët e propozuar nga prokuroria duke theksuar se citat: *ne dëgjojmë mendimin e ODD të BE-së në kudër të MIE i cili qenka bere këshilltar i larte ne Gjykatës Kushtetuese, e administron si provë vendimin e komisionit disiplinor për pozitat e nivelit të lartë drejtues dhe ju nuk e keni pas mirë por e kemi na mirë, vazhdojmë më rregulloret e Qeverisë së Kosovës rregullorja nr.6/121, par2. shqip thotë “ në bashkëpunim të ngushtë me institucione tjera identifikon dhe definon ... me qëllim të zbatimit të kritereve dhe obligimeve që dalin nga ..” dhe vazhdon me nenin 6 “në bashkëpunim të ngushtë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare promovon politika dhe aktiviteteteve ..” dhe kjo nuk kanë drejt me lobu si ka arrit këtu si ka arrit në këto objektiva. Narrativa e paraqitjes në krejt aktakuzën, në udhëzimin e saj ekspertin Sh, dëshmitari J dhe fjala përfundimtare e PSRK-së e tregon këtë.*

Avokati Florent Latifaj tutje ka shtuar se në shqyrtimin gjyqësor kemi pas fjalë se po ndahet Kosova, kemi pas fjalë të ekspertit që kompania që ka lobuar në Amerikë ka qenë kompani e hamburgerëve dhe aq i ka shkuar mendja se ka pa reklama me të njëjtin emër ndoshta u bë rastësisht nuk e di, por ka shansë se është bërë me hile se kurrë nuk ka me ardhur me të thënë se Dh.H e ke shkel nenin pesë dhe e ke bërë këtë dhe e ka thirre filanin apo fistekun dhe ty të krijohet një opinion që kështu paska ndodhur dhe të shohim çka ka ndodhur , ndërsa në anën tjetër ne ja kemi dhënë Web-in e saktë se kush është kompania dhe kush është mbrapa është shprehur avokati.

Mbrojtësi tutje është shprehur në fjalën e tij përfundimtare citat; *kemi opinionin e KRPP-së i cili po tentohet siç u tentua nga eksperti edhe sot tentohet, shumë qarte e kanë dhënë mendimin se sa na përket neve procedura është në rregull sa i përket kushteve objektive edhe këtu i përket AK, por as këtu KRPP-ja Departamenti i monitorimit nuk ka vërejte që konsideron me u sqaruar se le më të kundërligjshme dhe nuk kane kërkuar as sqarim dhe tani MIE duhet me shku me pyet prokurorinë me i thënë se sipas neve ky është objekti çka po mendoni dhe nëse thoni ju e ndalim lobimin.*

Mbrojtësi tutje ka deklaruar se ish ministrja H.. kërkesën e ka bërë ne bazë të ligjit dhe shton citat; *“çka bënë D.SH, e pyesin KRPP dhe kuptohet se këta nuk ja kanë bërë pyetjen se kështu ka thënë ministrja por ja ka dorëzuar gjithë dokumentacionin dhe duke i thënë se këtu kena mbërri dhe ata pastaj kane ardhur deri te ky përfundim”.*

Në fund të fjalës së tij përfundimtare mbrojtësi në fjalë ka deklaruar se në mungesë të tërësishme të edhe një elementi më të vogël, edhe një dyshimi te arsyeshëm, e jo të bazuar, një indice po them për gjithë por rastin, konkret edhe për të mbrojturën time, te ketë pasur ndonjë qëllim, të cilin kurrë nuk ka mundur hetuesia apo prokuroria, se cili ka qenë qëllimi të përfitoj kompania Amerikane apo Franceze. Unë propozoj të lirohet nga akuza e mbrojtura ime ka shtuar mbrojtësi krejt në fund.

6.3. E pandehura Dh.H në fjalën e saj përfundimtare e ka përkrahur në tërësi fjalën e mbrojtësit të saj duke theksuar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

6.4. Mbrojtësi i të pandehurit F.M– av.Mehdi Geci ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtimit gjyqësor të datës 24.04.2023 e në të cilën fjalë përfundimtare ka deklaruar; se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se aktakuza konstaton gjendjen të cilën nuk përkojnë me realitetin dhe me gjendjen faktike dhe se me dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë dhe provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se nuk ekziston përgjegjësia penale ndaj të mbrojturit tij dhe gjithashtu mungon elementi subjektiv i dashjes ngase nuk i ka mundur përfitim të dobisë pasurore personit tjetër, ashtu siç përfshihet në dispozitiv të aktakuzës. Po ashtu dëshmitarët e propozuar nga prokuroria dhe nga leximi i deklaratave të tyre dhënë në polici, prokurori dhe dëgjimi i tyre nuk kanë mundur të vërtetojnë dhe argumentojnë me asnjë provë të vetme se i mbrojturi im ka kryer veprën penale ka shtuar mbrojtësi. Ka theksuar se i pandehuri z.M ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi dhe nuk ka pasur asnjë shkelje ligjore. Vërtetohet se sa i përket këtyre dy aktiviteteve të prokurimit për të cilat akuzohet i mbrojturi im, mjetet kanë qenë të planifikuara në buxhetin dhe në planin e prokurimit të MIE për vitin fiskal 2018 dhe vitin 2019, ku parashihej “Shërbime lobimi dhe konsulencë ndërkombëtare” dhe gjithashtu për vitin fiskal 2019 ka qenë i përfshirë te pika me numër rendor të prokurimit 26 ku parashihej “Shërbime lobimi dhe këshillimi nga vendet e BE-

së dhe SHBA”, andaj i mbrojturi im vetëm se e ka zbatuar planet e prokurimit ashtu siç parashihet me LPP ka deklaruar mbrojtësi.

Tutje në fjalën e tij përfundimtare ky mbrojtës ka shtuar se ekspertiza financiare e ekspertit financiar dhe të prokurimit të rastet e konstatimeve e të elaborimeve ka shumë pasaktësi dhe shpesh në kundërshtim me veten e tij brenda asaj ekspertize. Gjithashtu në gjithë ekspertizën dhe aktakuzën, thuhet se i mbrojturi im ka aprovuar kërkesat e ministres, eksperti z.Sh nuk ka argumentuar me asnjë shkresë, asnjë provë materiale me të cilën vërtetohet se ministrija në këtë rast e pandehura z. i ka dërguar drejtpërdrejtë udhëheqësit z.M dhe as që ka aprovuar ndonjë kërkesë të saj. Më tej ka theksuar se veprimet e tij nuk paraqesin asnjë nga elementet e veprës penale, kur dihet se mandati i tij ligjor ishte zhvillimi i procedurave të prokurimit brenda organizatës buxhetore, në këtë rast brenda Ministrisë së Integrimeve Evropiane –MIE. LPP e lejon zhvillimin e procedurës së negociuar të prokurimit pa publikimin e njoftimit për kontratë. Mjetet buxhetore kanë qenë të parapara në buxhetin MIE për zhvillimin e procedurave për shërbime të konsulencës, si dhe plani i prokurimit për zhvillimin e procedurave kanë qenë të parapara dhe nuk ka pasur dëmtim të buxhetit. Prandaj, pretendimet e prokurorisë se i mbrojturi im duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ia mundësoi përfitimin e dobisë pasurore personit tjetër OE:”Majorelle PR& Events” si dhe “Madison Global Strategies LLC”, nuk qëndrojnë dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë, nuk ka asnjë provë të vetme të besueshme dhe të argumentuar se i pandehuri z.M, ka kryer veprat penale në vazhdimësi ashtu siç parashihet në aktakuzë ka përfunduar av.M G

6.5. I pandehuri F.M në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbështet në tërësi fjalën e avokatit të tij dhe nuk ka pasur diçka tjetër për të shtuar.

6.6. Mbrojtësi i të pandehurit D.SH – av.Tahir Rrecaj ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.04.2023 duke shtuar se prokurori pretendon se ministrija H ka tejkalluar kompetencat dhe autorizimet e saj për çka ka kryer veprën penale, për çka është akuzuar, një pretendim i tillë nuk qëndron aspak për shkak se edhe dëshmitarët e dëgjuar këtu në shqyrtim gjyqësor në veçanti dëshmitarja B V dhe dëshmitari D A në pyetjet e parashtruara nga mbrojtja e z.Sh kanë deklaruar shumë qartë se në kuadër të asnjë ministrie rrjedhimisht as në kuadër të MIE-së nuk ekziston një njësi kërkuese dhe tutje kane sqaruar se njësi kërkuese në kuadër të ministrive konsiderohet çdo zyrtar. Në pyetjen e mbrojtjes se a konsiderohet edhe ministrija ose ministri i cilësdo ministri si njësi kërkuese përgjigja e tyre ishte po, pra ministrija H nuk i ka tejkalluar autorizimet e saj kur ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës së prokurimit këtë rast pa publikimin e kontratës por ka mundur edhe përmes publikimit dhe nuk ka pengesë ligjore ka deklaruar av.Tahir Rrecaj.

Tutje ky mbrojtës ka shtuar citat; *“Nëse prokuroria dhe prokurori i pranishëm pretendon se ministria nuk e ka pas cilësinë e njësisë kërkuese pse nuk na tregon cila është ajo njësi kërkuese në kuadër të MIE dhe a ka një njësi të tillë sepse nëse do të kishte një njësi kërkuese në kuadër të ministrisë plotësisht do të ishte e drejte sepse do të kishte tejkalluar dhe në këtë rast nuk qëndron. Prokurori edhe në aktakuzë dhe fjalë përfundimtare pretendon se të gjithë të akuzuarit veprën penale e kanë kryer me dashje se ekziston elementi subjektiv i veprës penale për të cilën jemi këtu. Parashtrohet një pyetje sa logjike aq profesionale që përgjigjen e kemi të gjithë ne që kemi profesionist të kësaj lëmie. A mund të konsideron si ekzistim i dashjes kur i mbrojturi im D.SH për shkak të hezitimit dhe paqartësive që ka pas lidhur me ligjshmërinë e procedurës e ka pezulluar procesin, procedurën e prokurimit dhe ka kërkuar këshilla, udhëzimet juridike, ligjore nga të gjitha institucionet relevante në veçanti nga KRPP-ja që*



*është autoriteti i vetëm që bënë interpretimin e LPP-së, ka kërkuar mendim nga Departamenti i Drejtësisë i BE-së në kuadër të MIE-së dhe për më tepër e ka njoftuar edhe Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ka kërkuar të monitoroj procedurat lidhur me këtë çështje. Andaj pretendimi i PSRK paraqitur sot se z... ka kërkuar opinion nëse janë zbatuar dispozita e nenit 35 të LPP por nuk ka kërkuar opinion lidhur me atë nëse ministrja ka të drejte apo jo të inicioj një procedurë nuk qëndron”.*

Mbrojtësi Tahir Rrecaj në fjalën e tij përfundimtare ka shtuar se gjykata nuk është me shkruar ligjin apo me shfuqizuar ligjin por është me interpretuar dhe ligjin gjykata e interpreton edhe me ndihmën e ekspertit dhe ai ekspert ka qenë KRPP dhe ajo ka thënë se nuk ka shkelje, ku është dashja këtu ku është qëllimi këtu, dashja, qëllimi dhe pasoja e shkaktar nga vepra penale lidhet nga rrethanat faktike te rastit dhe cilat janë ato rrethana ku e vërtetojnë se z.SH e bënë publike dhe merr konfirmime pozitive. Se KRPP ka qenë në dijeni për kërkesën e parashtruar nga ministrja H vërtetohet dëshmitari D A në këtë gjykatë i cili mes tjerash thotë “kabineti i ministres H më ka ftuar në një takim urgjent me ministren dhe gjatë bisedës me ministren H ajo ka shfaqur një hezitim që e ka pasur D.SH lidhur me ligjshmërinë e procedurës” po ashtu thotë se ministrja i ka shpjeguar arsyet, qëllimet dhe benefitet dhe ka kërkuar që sa më parë të jetë e mundur qofte edhe brenda një ore të merr një opinion, pra KRPP veç i ka poseduar gjithë dokumentacionin përfshirë edhe kërkesën e ministres dhe nga vet ministrja ka qenë e njoftuar për një procedure të tillë dhe e kanë konfirmuar si krejtësisht të ligjshme. Prandaj propozoj që në pajtim me nenin 360/1 pika 1.3 të mbrojtur tonë ta lironi nga akuza sepse nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale që akuzohet ndërsa është e qartë se barra e të provuarit se i akuzuari e ka kryer veprën penale i përket gjithmonë prokurorisë ndërsa i akuzuari nuk është i detyruar të provoj pafajësinë e tij, ka përfunduar mbrojtësi.

6.7. I pandehuri D.SH në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka pasur çfarë të shtoj tjetër.

6.8. Mbrojtësja e të pandehurit K.C – av.Albana Kelmendi ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.04.2023 në të cilën fjalë përfundimtare ka potencuar: se aktakuza është në kundërtënie të plotë me dispozitivin dhe arsyetimin sepse sipas arsyetimit të aktit akuzues konstatohet se të pandehurit K.C, N O, D.SH dhe F M, me veprimet e ndërmarra formalisht kishin vepruar në kuadër të autorizimeve të tyre, por që në aspektin material veprimet e tyre ishin të kundërligjshme ngase ishte në kundërshtim me interesat dhe detyrat e shërbimit, ngase kishin lënë pas dore interesat dhe qëllimet e shërbimit, kishin aprovuar kërkesat e ministres të cilat ishin ushtruar duke tejkaluar kompetencat e saj dhe në këtë mënyrë ia kishin mundësuar përfitimin e dobisë pasurore operatorëve ekonomik. Ka shtuar se edhe pas shqyrtimit gjyqësor prokuroria ka dështuar të argumentoj përgjegjësinë penale të z.C, kjo së paku nuk është arrit të vërtetohet me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, prokuroria si organ i ndjekjes, obligohet që t’i provojë para gjykatës pretendimet e prezantuara në akuzë. Prandaj prokuroria ka dështuar ta argumentojë akuzën dhe atë në asnjë fazë të procedurës e as në shqyrtimin kryesor, meqë gjykatës nuk i ka ofruar prova të pa kontestueshme me të cilat do të vërtetohej ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësia penale e z.C. Ka theksuar se të gjithë dëshmitarët e propozuar nga organi i ndjekjes, janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor dhe nga deklaratimet e tyre është vërtetuar e kundërta e asaj që organi ndjekjes ka pretenduar. Po ashtu nga dëshmitë e këtyre vërtetohen faktet se kontrata e lidhur me OE, objekt i kontratave ka qenë promovimi i integriteteve evropiane të Kosovës, lobimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare veçmas në Francë, aktivitete integruese, takimet me institucionet e BE-së dhe lobimi i Kosovës, për shkak

se në atë kohë ka qenë edhe një fushatë kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe lobimi për liberalizimin e vizave ka shtuar mbrojtësja.

Sipas av. Albana Kelmendi aktivitetet e prokurimit ishin negociuar në pesë shtylla kryesore që kanë pas të bëjnë me rritjen e subjektivitetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, në organizatat e përbashkëta ku merr pjesë BE dhe SHBA, në planifikimin e dokumenteve strategjike për Kosovën, në koordinimin e fondeve të huaja dhe në njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet të cilat nuk e kanë njohur deri më tani. Kontratat në rastet kur janë vlerat e mëdha i nënshkruan edhe sekretari edhe ministri. Në fund ka shtuar se organi i ndjekjes nuk e ka përmbushur detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve edhe pse ka për obligim që me përkushtim maksimal të përkujdeset edhe për faktet të cilat shkojnë në favor të akuzuarit. Edhe pse është i autorizuar të bëjë ndjekjen e kryesve të veprave penale, organi i ndjekjes nuk është i liruar nga angazhimi për të gjetur të vërtetën, për këtë arsye e në këtë rast kërkojmë që z. C të lirohet nga akuza, ky veprim i gjykatës do të ishte i drejtë dhe i ligjshëm, ka përfunduar mbrojtësja.

6.9. I pandehuri K.C në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e avokates së tij duke theksuar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

6.10. Mbrojtësi i të pandehurit N.O– av.Hajzer Salihu ka deklaruar; se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim dhe të cilën e ka elaboruar në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.04.2023 e në të cilën fjalë përfundimtare ka deklaruar se prokuroria ka ngritur aktakuzën ndaj të mbrojturit të tij në bazë të supozimeve e jo fakteve dhe provave si dhe ka dështuar që të administroj dhe vlerësoj provat shfaqësuese, të cilat sigurisht se po t'i merrte për bazë, do të bindej se nuk ka pasur asnjë provë të vetme me të cilën do ta vërtetonte dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij me dashje, duke e shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, i ka mundësuar përfitimin e dobisë pasurore personit tjetër, në këtë rast OE “Majorelle PR&Events”. Ka shtuar se; citat “*veprimi i të mbrojturit tim lidhur me aktin e nënshkrimit të kontratës, konsiderojmë se ishte bërë pasi që i njëjti kishte marr siguri nga këto opinione se procedura e aplikuar me rastin e prokurimit ka qenë në rregull, duke pasur parasysh se KRPP-ja është autoriteti i vetëm kompetent për interpretimin e dispozitave të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik si dhe duke u ndier i sigurt nga nënshkrimi paraprak i zyrtarit përgjegjës të prokurimit si konfirmim i rregullsisë së procesit. Po ashtu ka shtuar se gjykata duhet të vlerësojë edhe faktin se Raporti i Auditimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, i bërë në vitin 2019 për pasqyrat vjetore financiare të MIE për vitin 2018, ka përfshirë edhe fushën e prokurimit publik, ku nuk ka të gjetura dhe asnjë shkelje të vetme në fushën e prokurimit dhe si rrjedhojë nuk ka pasur as rekomandime për këtë fushë, ndërsa Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është një prej opinioneve më të mira sipas standardeve të auditimit të jashtëm. Edhe nga asnjë dëshmitarë të propozuar nga prokuroria të cilët janë dëgjuar para kësaj gjykate me asnjë fjalë të vetme nuk e kanë inkriminuar të mbrojturin tim në kryerjen e veprës penale me të cilën është ngarkuar nga prokuroria. Nga provat në shkresat e lëndës, deklaramet e dëshmitarëve dhe ekspertit gjatë këtij procesi gjyqësor si dhe nga ky elaborim në këtë fjalë përfundimtare, kërkoj nga trupi gjykues që pasi të peshojë të gjitha provat dhe faktet e paraqitura ndaj të mbrojturit tim, të nxjerrë aktgjykim lirues”*

6.11. I pandehuri N.O në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e avokatit të tij dhe nuk ka çfarë të shtoj tjetër.

## 7. Gjetjet e Gjykatës.

7.1. Gjykata e bazon aktgjykimin e saj ne provat e procedura në shqyrtim gjyqësor dhe me ndërjegje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të saj ka arritur tek përfundimi se në këtë çështje penale nuk janë provuar faktet konkrete të cilat përbëjnë element kryesor të figurës së veprës penale e cila i është vënë në barrë të pandehurve.

Gjykata arsyetimit të këtij aktgjykimi do filloj nga baza ligjore, apo nenin inkriminues nga neni 414 par.2 të KPK-së, pra vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar i cili për element të kryerjes së kësaj vepre penale ka tejkalimin e kompetencave të personit zyrtarë ose mos përmbushja e detyrave zyrtare me qëllim përfitimi të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, ose shkelja e te drejtave të personit tjetër.

Te pandehurit janë akuzuar se me veprimet e tyre kanë shkaktuar dobi pasurore jo për vete por për personin tjetër dhe atë nuk janë akuzuar se këtë e kanë bërë në bashkëkryerje por secili veç e veç. Pra prokuroria ka pretenduar se elementi subjektiv i secilit të pandehur apo dashja e tyre veç e veç ka qenë që të i mundësojnë përfitim material kompanive Majorelle PR&Events dhe "Madison Global Strategies LLC". Shtrohet pyetja logjike, si është e mundur që dashja e secilit të pandehur është përputhur, pra që të gjithë kanë pasur për qëllim që ti mundësojnë të njëjtave kompani përfitim të kundërligjshëm e në anën tjetër nuk kanë bashkëpunuar.<sup>1</sup>

7.2. Elementi subjektiv është një nga elementët kryesor të kryerjes së veprave penale. Kjo është vullneti ose qëllimi i personit që të kryej veprën penale. Elementi subjektiv në kryerjen e veprave penale është "**mens rea**" ose qëllimi kriminal. Nëse një person nuk kishte qëllim të kryejë një veprim kriminal, atëherë nuk është fajtor për veprimin e tij, ngase kjo vepër kryhet vetëm me dashje direkte.

Gjykata konstatoi se në bazë të provave të administruara nuk është vërtetuar qëllimi kriminal i të pandehurve për të kryer veprën penale, ngase për gjykatën nuk është e mundur dhe nuk është provuar që të gjithë të kenë pasur të njëjtin qëllim për ti dhënë përfitim pasuror të kundërligjshëm kompanive Majorelle PR & Events dhe "Madison Global Strategies LLC", në anën tjetër nuk kanë bashkëpunuar në kryerjen e veprës penale. Është vërtetuar se në rastin konkret nuk ka pasur bashkëpunim sepse nuk ka asnjë provë për këtë, por ka pasur kryerje te detyrave zyrtare nga ana e të pandehurve, në kuadër të autorizimeve pa i kaluar kompetencat e tyre, këtë e vërtetojnë edhe veprimet e të akuzuarit D.SH, i cili i është drejtuar Komisionit Rregulativ të Prokurimit Publik (KRPP), e cila kishte dhënë opinion, si dhe ishte drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit. Pra që të gjithë të pandehurit si ish ministria H ashtu edhe F M, D.SH, K.C dhe N O, janë akuzuar vetëm se kanë marrë një veprim në kuadër të kompetencave të tyre në pozicionin që kishin në MIE, veprime këto që në fakt ishin përshtkrim i detyra të punës dhe në anën tjetër me asnjë provë nuk është vërtetuar se kur këta zyrtarë kanë hyrë në zonën penale.

Qëllimi për të mundësuar përfitim tjetrit nga ana e prokurorisë është supozuar dhe jo provuar ngase është e qartë që të pandehurit nuk kanë përfituar për vete (për këtë edhe nuk janë akuzuar) por nuk ka prova se të akuzuarit në cilësinë e personave zyrtar janë ndikuar nga presioni i personit tjetër, duke u kërcënuar ose duke u premtuar ndonjë përfitim nëse vepron në

<sup>1</sup> bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 31 të KPK-së e që është bashkëkryerja e që përcakton: " Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

përputhje me dëshirat e tyre, po ashtu në veprimet e të pandehurve nuk manifestohet mungesa e integritetit.

Personi zyrtar mund të shtyhet të keqpërdorë detyrën zyrtare për të mundësuar përfitim të kundërligjshëm personit tjetër për shkak të disa faktorëve si; 1. Personi zyrtar mund të jetë i korruptueshëm dhe të pranojë shpërblime ose dhurata nga personi tjetër në këmbim të favorizimit në procesin e marrjes së vendimeve, 2. Personi zyrtar mund të ketë interesat personale, si përfitim financiar ose përfitim nga vendime të caktuara që mund të pengojnë zbatimin e ligjit ose interesin publik, 3. Personi zyrtar mund të ndikohet nga presioni i personit tjetër, duke u kërcënuar ose duke u premtuar ndonjë përfitim nëse vepron në përputhje me dëshirat e tyre, 4. Personi zyrtar mund të mos ketë integritetin e nevojshëm për të mbajtur detyrën zyrtare me përgjegjësi dhe sinqeritet, duke ndërmarrë veprime që nuk janë në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Në bazë të provave të administruar në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar asnjëra nga këto katër rrethana, nuk ka as edhe një provë, madje nuk ka as edhe më të voglën indicie.

7.3. Në veprimet e të akuzuarës Dh.H nuk është vërtetuar tejkalimi i kompetencave<sup>2</sup> ngase në bazë të përshkrimit të detyrave të punës si ish ministre ishte përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin i politikave qeveritare në fushën e saj të përgjegjësisë. Bazuar në këtë ajo ka parashtruar tek D.SH i cili ishte Sekretar i Përgjithshëm i MIE, kërkesë për shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE të cilat kërkesa janë administruar si provë në shqyrtimin gjyqësor dhe janë të radhitura në pikën katër të arsyetimit të aktgjykimit, i cili si proces i inicimit është i ndarë nga vendimmarrja, ku më pastaj ky i fundit kishte kërkuar nga KRPP dy herë me radhë opinion në lidhje me ligjshmërinë e inicimit të procedurës. Opinionet e KRPP kishin qenë në frymën e shpjegimit të aspekteve procedurale deri në atë fazë që nënkupton inicimin e procedurës, ndërsa sa i përket aplikimit të procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë e kishte lënë në diskrediton të autoritetit kontraktues, duke e udhëzuar në çështjet të cilat AK duhet ti vlerësoj. Pra KRPP e kishte përpiluar opinion e saj në atë mënyrë që i kishte dhënë shumë diskrecion AK që ai të vendosë në lidhje me procedurën e cila do të zgjidhej, gjithmonë bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këto fakte kërkesën për opinion nga KRPP si organi i vetëm jo gjyqësor për interpretimin e LPP, pastaj opinionet e kësaj të fundit, si dhe bërja transparente e procesit në organet e tjera ligj zbatuese si Agjencia Kundër Korrupsionit, të gjitha këto tregojnë se në rastin konkret nuk ka pasur keqpërdorim më të ashtuquajturat autorizime diskrecionale. Dëshmitari O B, përpilues i opinionit të KRPP-së pak a shumë e ka thënë të njëjtën në shqyrtimin gjyqësor, duke bërë shpjegime procedurale dhe duke mos e mohuar të drejtën e AK që të vendosë në lidhje me procedurën nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Gjykata konsideron se ky lloj prokurimi për ofrimin e shërbimeve të konsulencës është i veçantë, (pra nuk është aktivitet prokurimi për furnizimi me sende ato që njihen në të drejtën civile) dhe është bërë për arsyeje të veçanta, dhe bazuar në legjislacionin në fuqi pra LPP dhe ligje tjera të aplikueshme nuk ka ndonjë autoritet që ka tagër për inicimin e një procedure të tillë, ngase LPP nuk përmban ndonjë dispozitë me të cilin shpjegon se cila është njësi kërkuese në kuadër të autoritetit kontraktues, andaj në rastin konkret është paraqitur ministrja, bazuar në natyrën e shërbimit që kërkohet. Pra në këtë rast vlen parimi “**Permittiur quod non prohibited**” që d.m.th. është e lejuar ajo e cila nuk është e ndaluar. Meqenëse konsulenca është sferë e veçantë edhe ky lloj prokurimi është i veçantë, tek kriteret teknike nuk vlejnë rregullat

<sup>2</sup> Spjegim për çështje teorike dhe praktike; çdo tejkalim i kompetencës nga personi zyrtarë nuk nënkupton se personi zyrtarë ka kryer veprim penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, nëse mungon elementi i dëmit, apo edhe elementi vulltiv i dashjes.

që vlejné për mallra, pajisje apo makineri, por vlejné rregulla tjera, ku në kërkesën e ministres për iniciimin e procedurës së prokurimit janë specifikuar këto arsye që në këtë rast duke u bazuar edhe në specifikën e prokurimit mund të quhen edhe teknike, ndonëse nuk kemi të bëjmë me mallra, e të cilat kritere në instancë të fundit ishin politike.

7.4. Nga dëshmitë e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar fajësia e të pandehurve. Dëshmitarja V H ka dëshmuar se ka qenë pjesë e komisionit për pranimin e pagesës për një periudhë të caktuar, ka shpjeguar procedurën se kush e ka caktuar në atë komision dhe si kanë vepruar. Dëshmia e kësaj dëshmitareje nuk përmban asgjë inkriminuese për të pandehurit.

7.5. Nga dëshmia e dëshmitares B V nuk është vërtetuar ndonjë element i veprës penale. E njëjta ka dëshmuar se ka qenë anëtare e komisionit për negocimin e kontratës dhe se negocimin e kontratës e kishin bërë përmes email herën e parë dhe herën e dytë kishin shkuar në Paris, që është anashkalim nga praktikat e negocimit të kontratave, por jo me rëndësi për ekzistimin e veprës penale. Nga deklarata e kësaj dëshmitareje gjykata e vërtetoj faktin se gjatë punës ky komision nuk kishte ndonjë presion nga kush do qoftë.

7.6. Nga dëshmia e dëshmitarit Dëshmitari V H gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë nga elementet e figurës së veprës penale të Keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar. I njëjti ka qenë anëtar i komisionit për pranimin e faturës së muajit tetor 2019, ka shpjeguar kush i ka caktuar dhe si kishin ardhur tek përfundimi që mos të pranohet për pagesë kjo faturë dhe cilat ishin ato arsye. Pra arsyet që janë cekur nga ky komision kishin të bënin me kompaninë fituese dhe jo me zyrtarët e MIE.

7.7. Gjukata gjithashtu nga dëshmia e dëshmitarit V J nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë element që do të përmbushte figurën e veprës penale për të cilin akuzohen të pandehurit. Edhe ky dëshmitar ka qenë anëtar i komisionit për pranimin e faturës së muajit tetor 2019, ka shpjeguar kush i ka caktuar dhe si kishin ardhur tek përfundimi që mos të pranohet për pagesë kjo faturë dhe cilat ishin ato arsye. Ka dëshmuar se i kishin dhënë mundësi kompanisë që të argumentonte punën e saj edhe në një rast të dytë, por sipas tij kompania kishte dështuar ta bënte një gjë të tillë dhe si komision kishin vendosur që pagesa të mos kryej. Ky dëshmitarë ka shprehur edhe disa nga dyshimet e veta, po ashtu ka shprehur edhe qëndrimet e tija në lidhje me këtë proces, ka shprehur edhe pikëpamjet e tija politike në lidhje me krejt situatën dhe një gjë e tillë është fare legjitime, mirëpo në lidhje me objektin e akuzës i cili është konkret dhe i ngushtë, nuk kanë ndonjë relevancë provuese.

7.8. Gjukata po ashtu i ka bërë një analizë dëshmitarit D A dhe nga dëshmia e tij nuk rezulton diçka inkriminuese. I njëjti në cilësinë e zyrtarit të zyrës ligjore në MIE kishte hartuar një opinion ligjor i cili është administruar si provë në shqyrtimin gjyqësor dhe është i listuar në pikën katër të arsyetimit të këtij aktgjykimi. Opinioni është i gjatë mirëpo thelbi i tij është se zyra ligjore nuk është kompetente që të jap në mënyrë të prerë opinione të tillë, por si e ka quajtur dëshmitari i njëjti ka karakter këshillues. Ky raport përshkohet me elaborim të bazës ligjore dhe parafrazim të dispozitave dhe në esencë rekomandon që vendimi duhet të merret nga vendimmarrësit e AK-së. Nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet se e pandehura Dh H, megjithatë për ti hequr dilemat në lidhje me procedurat kishte kërkuar nga kjo zyrë një opinion ligjor, edhe pse atë nuk e ka marrë sepse opinioni në leksikun e tij kishte ambiguitet.

7.9. Ekspertiza ekspertit A Sh e datës 28.05.2021 paraqet aspekt të përgjithshme teorike sa i përket konkurrencës, ofertës - kërkesës dhe çmimit më të favorshëm, të cilat të shkëputura nga

konteksti i kësaj lënde qëndrojnë dhe ky është rregull, mirëpo ekziston edhe përjashtimi nga ky rregull i cili është paraparë me nenin 35 të Ligjit të Prokurimit Publik, pra procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, në këtë kuadër edhe shkëlja e të drejtave të konkurrentëve të tjerë potencial në këtë aktivitet të prokurimit dhe shkaktimi i dëmit për ata, apo për këdo është abstrakt dhe i pakuptimit në rastin konkret, andaj në veprimet e të pandehurve nuk manifestohen as elementet e përgjegjësie objektive. Ekspertiza e këtij eksperti në disa pjesë trajton mos përmbushje të pozicioneve që kanë qenë objekt i kësaj kontrate dhe sipas ekspertit nuk është përmbushur në tërësi objekti i kontratës si dhe ka paraqitur vërejtje të përshkrimi i shërbimit, i cili pastaj është paguar nga MIE, mirëpo si të tilla mbesin të sferës administrative apo të marrëdhënies së detyrimeve dhe nuk përmbajnë elemente penale.

7.10. Analiza e dokumenteve të rastit është një nga metodat që përdoren për zbulimin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga zyrtarët publik, por në shumicën e rasteve nuk është e mjaftueshme. Është e nevojshme të kryhet një hetim i plotë për të provuar veprimet e zyrtarit, dhe për të siguruar prova të nevojshme për ndjekjen penale. Me hetimin e bërë nuk është vërtetuar elementi volitiv si pjesë kryesore e kryerjes së veprave penale të korrupsionit. Ai përfshin qëllimin e personit që kryen veprën penale, pra nga cilët faktorë është ndikuar ai në vendosjen e tij për të kryer veprën penale. Në këtë rast, elementi volitiv lidhet me qëllimin e korrupsionit, i cili në rastin konkret nuk është vërtetuar pas hetimit të bërë. Prokuroria ka bërë një hetim më shumë administrativ dhe post festum ka bërë një analizë të dokumentacionit të lëndës së prokurimit që ishte objekt i kësaj akuzë duke i interpretuar LPP-në dhe ligje tjera, duke u shërbyer edhe me ekspertizën e ekspertit, mirëpo prova konkrete inkriminuese konvencionale për të drejtën penale me të cilat dëshmohet vepra penale, dëshmohet se të pandehurit kanë hyrë në zonën penale të veprimit gjykata nuk ka gjetur.

Gjykata penale, në këtë çështje ka pasur objekt shqyrtimin e veprës penale për të cilën të pandehurit janë akuzuar dhe jo ndonjë përgjegjësi tjetër eventuale. Gjykata nuk ka trajtuar nëse janë arritur në masën njëqindpërqind objektivat e parashikuar me kontratë, sepse kjo i përket përgjegjësisë politike apo elektorale, apo ndonjë përgjegjësie tjetër që nuk është në mandatin gjykatës ta komentoj.

Qëllimi kryesor i procesit gjyqësor është që rasti penal të provohet përtej dyshimit të bazuar mire. Provimi i rastit penal ka një standard të lartë të provave dhe kërkon që të gjithë elementet e një veprë penale të provohen me një nivel të lartë të sigurisë dhe të besueshmërisë. Gjykata duhet të jete e bindur se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme për të arritur një vendim të drejtë.

7.11. Sentenca latine për pafajësinë është **Ei incumbit probatio qui dicit, non qui negat**, e cila nënkupton se detyra e provës i takon atij që pretendon, jo atij që mohon. Kjo sentencë është një parim themelor në sistemin ligjor të shteteve të shumta të botës. Kjo tregon se në një procedurë gjyqësore, personi që akuzohet për një krim nuk duhet të provojë pafajësinë e tij, por në fakt, është detyra e akuzës për të provuar fajin e tyre përpara gjykatës. Ky parim konsiderohet si një aspekt themelor i drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor.

Parimi "**in dubio pro reo**" është një parim juridik i cili përcakton se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen apo për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij në pajtim me Kodin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky parim qëndron në relacion të drejtë me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe domosdoshmërisë së mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Nga arsyet e cekura me lart, trupi gjykues nuk ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurve manifestohen elementet e veprës penale me të cilën janë akuzuar.

Gjykata konform nenit 462 par.1 dhe par.2 të KPPRK-së ka vendosur për kërkesën pasurore juridike, andaj të dëmtuarën sipas aktakuzës së prokurorisë Qeveria e Kosovës për realizmin e kësaj kërkesë e ka udhëzuar në kontest civilo – juridik.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 453 par.1. të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL  
PS.nr.31/21, dt.28.06.2023

Zyrtarja ligjore:  
Shqipe Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari:  
Arben Hoti

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.